

Ungjilli pas Markut



Krye 1.

- 1 Të-nisurit' e ungjillit të Jisu Krishtit, të
- 2 Birit të Perëndisë; Sikundrë është skruarë ndë
profitërit „Na unë tek po dërgonj ëngjëllinë
t' im përpara faqesë s' ate, i-cili dotë ndreq-
- 3 një udhënë t' ende përpara teje“. „Zër' i ati
që bërtet ndë shkretëtirët, Bëni gati udhën' e
Zotit, bëni të-drejta rrugat' e ati.“
- 4 Joani ishte dyke pagëzuarë ndë shkretë-
tirët, edhe dyke lëçiturë pagëzim pendimi për
- 5 ndjesën' e fajevet. Edhe dilninë tek ay gjithë
vëndi i Judhesë edhe Jerosolimitëtë, edhe të-
gjithë pagëzonzeshinë nga ay ndë lumët të
Jordhanit, dyke rrëfyerë fajet' e tyre.
- 6 Edhe Joani ishte veshurë me qime kamille,
edhe *kishte* bres të-lëkurtë rreth mesit të ti
- 7 edhe hante karkaleca e mjaltë t' egërë. Edhe
lëçiste, dyke thënë, Prapa meje vjen më i-
forti se unë, të-cilit s' jam i-zoti të unjem e
- 8 t' i sgith rripin' e këpucëvet. Unë u pagëzo-
va juve me ujë; po ay dot' u pagëzonjë juve
me Frymë të-Shënjtëruarë.
- 9 Edhe nd' ato dit erdhi Jisuj nga Nazareti

- i Galilesë edhe upagëzua nga Joani ndë Jor-
 10 dhant. Edhe për-një-here, dyke dalë nga u-
 jëtë, pa qiejtë dyke hapurë edhe Frymën' e-
Shënjtëruarë posi pëllump dyke zbriturë mbi
 11 atë. Edhe erdhi një zë nga qiejtë, Ti je Biri
 im i-dashurë që e kam pëlqyerë.
 12 Edhe për-një-here Fryma e nxjer ndë
 13 shkretëtirët. Edhe ish atje ndë shkretëtirët dy-
 zet dit, e ngitej nga Satanaj; edhe ish bashkë
 me egërsiratë; edhe ëngjëjt' i shërbeninë.
 14 Edhe passi udha ndër duar Joani, Jisuj
 15 erdhi ndë Galilet, dyke lëçitur' Ungjillin' e
 mbretëris' së Perëndisë, dyke thënë, Se u-
 mbush koha, edhe uafërua mbretëri' e Perën-
 disë; pendohi, edhe i besoni ungjillit.
 16 Edhe dyke ecurë ndaj detit të Galilesë,
 pa Simonë edhe Andrenë të vëllan' e ati që
 po hithninë rrietë ndë dett; sepse ishinë pesh-
 17 katarë; Edhe Jisuj u tha atyre, Ejani pas
 meje, edhe dot' u bënj juve të bëhi peshka-
 18 tarë njerëzish. Edhe *ata* për-një-here lanë
 rrietat' e tyre, edhe vanë pas ati.
 19 Edhe dyke vaturë prej andej pak më tej
 pa Jakovinë të birr' e Zevedheut, edhe Joa-
 ninë të vëllan' e ati edhe tek ishinë ndë lun-
 20 drët dyke ndrequrë rrietatë. Edhe për-një-
 here thirri ata; edhe *ata* lanë t'an' e tyre
 Zevedhenë ndë lundrët bashkë me punëtorëtë,
 edhe vanë pas ati.
 21 Edhe hyjnë ndë Kapernaum; edhe *Jisuj*

- për-një-here *ditën'* e-shëtunë hyri ndë sina-
 22 gogjit, e mësonte. Edhe çuditëshinë për më-
 simn' e ati; sepse ishte dyke mësuar' ata si
ndonjë që ka pushtet, edhe jo si shkronjësitë.
 23 Edhe ishte ndë sinagogjit t' atyre një njeri
 që kish frymë të-ndyrë, edhe bërtiti dyke
 24 thënë, Mjerë! ç' ke ti me ne, Jisu Nazarinas?
 erdhe të na humbaç? të di cili je, Shenjti i
 25 Perëndisë. Po Jisuj e qërtoj, dyke thënë,
 26 Mbyll gojënë, edhe dil nga ay. Edhe frym' e-
 ndyrë, si e shkleu, edhe bërtiti me zë të-math,
 dolli nga ay.
 27 Edhe të-gjithë uhabitnë kaqë sa pyesninë
 njëri tjetrinë. dyke thënë, Ç' është këjo? ç' është
 ky mësim i-ri? sepse me pushtet urdhëron
 28 edhe frymat' e-ndyra, edhe i bindenë. Edhe
 për-një-here i dolli zëri ndëpër gjithë vëndi-
 në rreth Galilesë.
 29 Edhe për-një-here duallnë nga sinagogjia
 e ertnë ndë shtëpit të Simonit e të Andreut,
 30 bashkë me Jakovin' e me Joaninë. Edhe e
 vjehërr' e Simonit po dirgjej ndër ethe; edhe
 31 për-një-here i thonë për atë. Edhe ay uafë-
 rua edhe dyke rrokurë atë prej dore e ngriti;
 edhe e lanë ethetë për-një-here, edhe *ajo* u
 shërbente atyre.
 32 Edhe si ungrys, mbë të-perënduarët të
 djellit, prunë tek ay gjith'ata që kishinë keq
 33 edhe të-djallosuritë; Edhe tërë qyteti ish mble-
 34 dhurë te dera. Edhe shëroj shumë që vua-

- ninë prej smundjesh të-ndryshme; edhe shumë djaj kërreu, edhe s' linte djajtë të flasënë, sepse e njihninë.
- 35 Edhe ndë mëngjest fort me natë ungrit e doli, edhe vate ndë një vënt të-shkretë, edhe falej atje.
- 36 Edhe e ndoqnë prapa Simoni edhe ata që
- 37 ishinë bashkë me atë; Edhe kur e gjetnë, i
- 38 thonë, se të-gjithë po të kërkonjënë. Edhe ay u thot' atyre, Le të vemi ndë kryefshatrat t' Vafërma, që të lëçis edhe atje; sepse për këtë
- 39 *punë* kam dalë. Edhe ishte dyke lëçiturë ndëpër sinagogjit t' atyre, ndëpër gjithë Galilenë, edhe dyke kërryerë djajtë.
- 40 Edhe vjen tek ay një i-krromosur' e i lutetë, edhe bje ndë gjunj përpara ati, e i thotë,
- 41 Se, po të duash, munt të më qërojsh. Edhe Jisujt i udhëmp, e ngjati dorënë, edhe e preku
- 42 e i thotë, Dua, qërohu. Edhe ay posa tha *këtë*, për-një-here i shkoj krroma, edhe u-
- 43 qërua. Edhe si e porositi shtrënguarë, për-
- 44 një-here e kërreu jashtë, Edhe i thotë, vështro se mos i thuash gjë ndonjëj, po shko, e dëfte vetëhenë t' ënde te prifti, edhe bjerë për të-qëruarëtë t' ënt ato që ka urdhëruarë
- 45 Moisiu për dëshmim mb' ata. Po ay si doli nisi të lëçisë shumë, edhe të përhapnjë fjalënë, kaqë sa ay s' munte më të hynte faqeza ndë qytet, po ishte jashtë ndëpër vënde të-shkretë, edhe vininë tek ay nga të-gjithë anëtë.

Krye 2.

- 1 Edhe pas *ca* ditsh përsëri hyri ndë Kapërnaum; edhe udëgjua se është ndë një
- 2 shtëpi. Edhe për-një-here umplotnë shumë *veta*, kaqë sa as vëndetë për anë derësë s' i nxininë më; edhe ay u lëçiste atyre fjalënë.
- 3 Atëhere vijnë tek ay, e bjenë *një* ulok
- 4 ngriturë prej katrë *vetash*. Edhe passi s' muntninë të afëroëshininë tek ay nga gjindja *e-shumë*, sbuluanë kulminë ku ishte ay, edhe si bënë vërë, sbritnë shtratnë, përmbi
- 5 të-cilinë dirgjej ulogu. Edhe Jisuj, kur pa besën' e atyre, i thot' ulogut, Bir, t' ufal në
- 6 fajet' e tu. Edhe ca nga shkronjësit' ishinë atje dyke ndënjurë, edhe dyke menduarë ndë
- 7 zëmërat të tyre, Ç' flet ky kështu vllasfirmira? cili munt të falnjë faje, përveç se një,
- 8 Perëndia? Edhe Jisuj për-një-here si e mori vesh me frymën' e ti se po mendonenë kështu me vetëhen' e tyre, u tha atyre, Përse
- 9 mendoni këto *punë* ndë zëmërat t' uaj? Ç' është më kollaj t' i them ulogut, T' ufal në fajetë, apo t' i them, Ngreu, e merr shtratnë
- 10 t' ënt, edhe ecë? Po që t' a dini, se i bir' i njeriut ka pushtet të falnjë faje mbi dhet,
- 11 (i thot' ulogut,) Tyj të them, Ngreu, e merr shtratnë t' ënt, edhe shko ndë shtëpit t' ënde.
- 12 Edhe ay ungrit për-një-here, edhe mori shtratnë, edhe doli përpara të gjithëvë; kaqë sa të-gjithë çuditëshinë, edhe lavduroninë Pë-

- rëndinë, dyke thënë, Se askurrë s' kemi parë keshtu.
- 13 Edhe dolli përsëri ndaj detit; edhe gjithë gjindja vinte tek ay, edhe ay i mësonte.
- 14 Edhe dyke shkuarë pa Levinë të birrë e Allfeut dyke ndënjurë ndë kumerqt; edhe i thotë, Eja pas meje. Edhe ay ungrit e vate pas ati.
- 15 Edhe kur po rrinte ndë mësallët ndë shtëpit t' ati, ishin' unjurë ndë mësallët edhe shumë kumerqarë e fajtorë bashkë me Jisun' e me nxënësit' e ati; sepse ishinë shumë
- 16 veta, edhe vanë pas ati. Edhe shkronjësit' e Farisenjtë, kur pan' atë dyke ngrënë bashkë me kumerqarë e me fajtorë, u thoshinë nxënëset t' ati, Përse ha e pi ay bashkë me kumerqarë e me fajtorë? Edhe Jisuj, kur dëgoj, u thot' atyre, Të-shëndoshëtë s' kanë nevojë për shëronjës, po ata që vuanjënë; s' kam ardhurë për të thirrurë të drejtë, po fajtorë (ndë pendim).
- 18 Edhe nxënësit' e Joanit edhe ata të Farisenjvet agjëroninë; edhe vijnë, e i thonë Përse nxënësit' e Joanit e ata të Farisenjvet agjëronjënë edhe nxënësit e tu s' agjëronjënë? Edhe Jisuj u tha, Mos muntnjënë t' agjëronjënë dasmorëtë, gjersa të jetë dhëndërrri bashkë me ata? sa kohë kanë dhëndërrinë me vetëhen' e tyre, s' muntnjënë
- 20 t' agjëronjënë; Po dotë vijnë dit, kur dotë

- merretë dhëndërrri, edhe atëhere dot' agjëronjënë nd' ato dit. Edhe asndonjë s' qep anërrë pëlhure së-re mbë rrobë të-vjetërë; ndë mos, të-mbushurit' e asaj të-ri heq prej së-vjetërësë,
- 22 edhe të-grisuritë bënetë me të-keq. Edhe asndonjë s' vë verë të-re ndë calikë të-vjetërë; ndë mos, ver' e-re gris calikëtë, edhe vera derdhetë, edhe calikëtë prishenë; po ver' e-re duhetë të vihetë ndë calikë të-rinj.
- 23 Edhe ay tek po shkonte një ditë të-shëtunë ndëpër ara të-mbjella, nxënësit' e ati, dyke bërë udhë, zunë të çkoqjënë kallinj.
- 24 Edhe Farisenjt' i thoshinë, Shih, përsë bëjnë ditën' e-shëtunë atë që s' është' e udhësë?
- 25 Edhe ay u thosh atyre, Askurrë s' kini këndruarë ç' bëri Dhavidhi, kur pat nevojë, edhe i erdhi uri ati edhe atyreve që ishinë bashkë me atë? Qysh hyri ndë shtëpit të Përendisë ndë ditët të Aviathar krye-priftit, edhe hëngri bukët' e parëvënjesë, të-cilatë s' është' e udhësë t' i hajë tjetërë njeri, veç priftërvet, edhe u dha edhe atyreve që ishinë bashkë me atë? Pasandaj u thoshte atyre, E-shëtuna ështëë bërë për njerinë, e jo njeriu për të-shëtunënë; Përandaj i bir' i njeriut është' i-zoti edhe i së-shëtunësë.

Krye 3.

- 1 Pasandaj hyri përsëri ndë sinagogjit; edhe atje ish një njeri që kish dorënë të-thatë.

- 2 Edhe vininë re atë, a dot' a shëronte atë
 3 *ditën'* e-shëtunë, që t' a përfllisinë. Edhe ay i thotë njeriut që kishte dorënë të-thatë,
 4 Ngreu e *qëndro* ndë mest. Pasandaj u thot' atyre, *Ësht'* e udhësë të bënë njeriu mirë të-shëtunatë, apo të-bënjë keq? të-shpëtonjë shpirt, apo të vrasë? Po ata s' bëninë zë.
 5 Atëhere si i vuri re reth me zëmërim, sepse i erdhi keq për ashpërimn'e zëmërs' s' atyre, i thotë njeriut, Shtri dorënë t' ënde. Edhe ay e shtriu; edhe dor' e ati ubë e shëndoshë
 6 (posi tjetëra). Edhe Farisenjtë si dualinë, për-një-here bënë këshillë bashkë me Irodhianëtë kundër ati, që t' a prishnjënë.
 7 Edhe Jisuj shkoj bashkë me nxënësit' e ti mb'anët të detit; edhe i vanë pas shumë
 8 shumicë nga Galilea, e nga Judhea, E nga Jerusalmi, e nga Idhumea, e që përtej Jordhanit; edhe shumë shumicë nga ata që i-shinë rreth Tyrës' e Sidhonësë, kur dëgjuanë
 9 se sa *punëra* bënte, erdhë tek ay. Edhe ay u tha nxënësve të ti t' a presë atë afërë një lundrë, për punë të gjindjesë, që të mos e
 10 shtrëngonjë. Sepse shëroj shumë *veta*, kaqë sa bininë sipër ati, që t' a preknjë, sa
 11 *veta* kishinë smundje. Edhe frymat' e-ndyra, kur e vështroninë, i bininë përpara, edhe bërtisininë, dyke thënë, Se ti je i bir' i Perëndisë. Po ay shumë i qërtonte, që të mos e çfaqnjënë.

- 13 Pasandaj hipën ndë malt, edhe thërret për-anë vetëhes sa *njerës* deshi ay; edhe *ata*
 14 vanë tek ay. Edhe sgjodhi dy-mbë-dhjetë *veta*, që të jenë bashkë me atë, edhe që t' i
 15 dërgonjë të lëçisnjënë, Edhe të kenë pushtet të shëronjë smundjetë, edhe të kërrënjënë
 16 djajtë; Simonë, që j' a vuri emërin Pjetër;
 17 Edhe Jakovinë të birrë e Zevedheut edhe Joannë të vëllan' e Jakovit, edhe u' a vuri emërin Voanergjes, që do-me-thënë, Bij bu-bullime; Edhe Andrenë, e Filipnë, e Varthollomenë, e Matthenë, e Thomanë, e Jakovinë të birrë e Allfeut, e Thadhenë, e Simon
 19 Kananitinë, Edhe Judhë Iskariotinë, i-cili edhe e trathëtoj.
 20 Edhe vijnë ndë *një* shtëpi; edhe mblidhetë përsëri gjindje, kaqë sa ata s' muntinë
 21 të hanin' as bukë. Edhe kur dëgjuanë njerëzit' e ati, dualinë t' a mbajnë, sepse thoshinë, Se është jashtë mënç.
 22 Edhe shkronjësitë, që sbritnë nga Jerusalmi, thoshninë, Se ka Veelizevulinë, edhe se kërrën djajtë me anë të të-parit të djajvet.
 23 Po ay, si i thirri ata për-anë, u thoshte me paravolira, Si munt të kërrëjë Satanaj
 24 Satananë? Edhe një mbretëri ndë undaftë kundër vetëhes' se saj, ajo mbretëri s' munt
 25 të qëndronjë; Edhe një shtëpi ndë undaftë kundër vetëhes' së saj, ajo shtëpi s' munt të
 26 qëndronjë. Edhe Satanaj ndë ungrit kundër

vetëhes' së tij, edhe unda, s' munt të qëndronjë, po i erdhi fundi. Asndonjë s' munt të hynjë ndë shtëpit të të-fortit e të rrëmbenjë enët' e ati, ndë mos e lithë më përpara të-fortinë; edhe atëhere do të rrëmbenjë shtëpin' e ati. Me të-vërtetë po u them juve, Se bijvet të njerësvet dot' u ndjenenë gjithë fajetë edhe të-sharatë sa që të shanjë-në, Po ay që të shanjë kundër Frymës' së-Shënjtëruarë, nukë ka ndjesë për gjithë jetë-në, po është fajtuar për dënim të-pasosurë; 28 Sepse thoshninë, se Ka frymë të-ndyrë. 29 Vijnë pra të vëllezërit' edhe e ëm' e ati, edhe si qëndruanë jashtë, dërguanë tek ay, 30 që t' a thërresënë. Edhe rreth ati rrinte gjindje; edhe i than' ati, Na jot' ëmë edhe t' ët 31 vëllezër te po të kërkoinë jashtë. Po ay u-përgjeq atyreve, dyke thënë, Cila është im' 32 më a cilëtë janë t' ëm vëllezër? Edhe si hodhi sytë rrotullë mb' ata që rrininë përanë 33 ati, tha, Na im' më edhe t' ëm vëllezër Sepse ay që të bënë dashurimn' e Perëndisë, ky është im vëlla, edhe ime motrë, edhe mëmë.

Krye 4

1 Edhe përsëri zu të mësonte ndaj detit; edhe umbloth përan' ati shumë gjindje, kaqë sa ay hyri ndë lundrët edhe rrinte ndë dett; 2 Edhe tërë gjindja ishte mbi dhet përanë detit edhe i mësonte ata shumë gjërëra me

paravolira, edhe u thosh atyre ndë mësimt të ti. 3 Dëgjoni; na tek dolli mbjellësi të mbjellë; 4 Edhe mbë të-mbjellurit, një pjesë ra mb' udhët, edhe erthnë shpest' (e qiellit) edhe e 5 hangrrë. Edhe tjatëra ra mbë gurishtet, ku s' kish dhe shumë, edhe për-një-here biu, sepse s' kish dhe të-thellë; Po kur leu djelli, u doq, edhe me-qënë-që s' kish rrënjë, utha. 6 Edhe tjatërë ra ndë drizat; edhe drizatë hipnë edhe e mbytnë, edhe pemë s' dha. Edhe tjatërë ra ndë dhet të-mirë, edhe epte pemë dyke hipur' e dyke rriturë, edhe pruri pemë njëra tri-dhjetë, e njëra gjashtë-dhjetë, e njëra 7 ra një qint.—Edhe u thoshte atyre, Ay që ka veshë për të dëgjuarë, letë dëgjonjë. 8 Edhe kur mbeti vetëmë, ata që ishinë rreth ati bashkë me të dy-mbë-dhjetëtë e 9 pyetnë për paravolinë. Edhe ay u thoshte atyre, Mbë ju është dhënë të njihni fshehesirën' e mbretëris' së Perëndisë; po mb' ata që janë jashtë, të-gjitha bënë me paravolira, 10 Që dyke parë të vështronjënë, edhe të mos shohënë; edhe dyke dëgjuarë të dëgjonjënë, edhe të mos kupëtonjënë, semos ndonjë- 11 herë kthenen e u falenë fajetë. Pasandaj u thot' atyre, Nuk' e dini këtë paravoli? edhe si dotë kupëtoni gjithë paravolitë? 12 Mbjellësi është ay që mbjell fjalënë. 13 Edhe ata përan' udhësë janë këta, ndë të-

- cilët mbilletë fjala; po kur dëgjonjënë, për-
një-herë vjen Satanaj, e u merr fjalënë që
16 është mbjellë ndë zëmërat t' atyre. Edhe gjith-
ashtu ata që mbillenë ndë gurishtet janë
këta, të-cilëtë, kur dëgjonjënë fjalënë, për-
një-herë e marrënë me gëzim; Po s' kanë rrë-
një ndë vetëhet të tyre, po janë për pak ko-
hë; pasandaj, kur bënetë shtrëngim a të-
ndjekurë për fjalënë, për-një-herë skandha-
18 lisenë. Edhe ata që mbillenë ndë drizat janë
19 këta, të-cilëtë dëgjonjënë fjalënë; Po kujde-
set' e kësaj jete, edhe të-gënjyerët' e pasjesë,
edhe dëshërimetë për të-tjera *gjëëra*, hynjë-
në e mbytnjënë fjalënë, edhe *kjo* bënetë e-
20 papemshime. Po ata që umbollnë ndë dhet
të-mirë janë këta, të-cilëtë dëgjonjënë fjalë-
në, edhe e presënë, edhe bjenë pemë, një
tridhjetë, një gjashtë-dhjetë, edhe një një qint.
21 Edhe u thoshte atyre, Mos vjen kandili,
që të vihetë ndënë shinikt a ndënë shtratt?
22 nukë që të vihetë mbi kandilert' Sepse s' ka
gjë të-fshehëtë që të mos shpalletë; as nuk'
është bërë ndonjë gjë e-fshehurë, që të mos
23 çfaqetë. Ndë ka ndonjë veshë për të dëgju-
arë, letë dëgjonjë.
24 Edhe u thoshte atyre, Vini re ç' dëgjonj;
me ç' matës matni, dot' u matetë *edhe* juve.
25 edhe dotë shtonetë mbë ju që dëgjonj. Sep-
se ati që ka dot' i epet' *edhe tjetërë*, edhe ati
që s' ka, edhe ajo që ka dotë merretë prej ati.

- 26 Edhe thoshte, Kështu është mbretëri' e
Perëndisë, posi një njeri që heth farënë mbë
27 dhet, Edhe fle e ngrihetë nat' e ditë: edhe
fara mbin, edhe rritetë, kështu që ay s' e di
28 *se qysh*. Sepse dheu prej vetiu bje pemë,
më parë bar, pastaj kalli, pastaj të-plotë
29 grurë ndë kallit. Edhe kur arrihetë pema,
dërgon drapërinë, sepse arriu të-korrëtë.
30 Edhe thoshte, Me se t' a përgjajmë mbrë-
tërin' e Perëndisë? a me ç' farë paravolie t' a
31 mbarasojmë? Eshtë si një koqe sinapi, e ci-
la, kur mbilletë ndë dhet, është m' e-vogëlë
32 se gjithë faratë që janë mbi dhet; Po si
mbilletë, rritet' e bënetë më e-madhe se gji-
thë lakëratë, edhe bën dega të-mëdha, kaqë
sa shpest' e qiellit munt të rrinë ndënë hijet
t' asaj.
33 Edhe me shumë të-këvilla paravolira u
fliiste atyre fjalënë, sikundrë muntninë t' a
34 dëgjoninë. Edhe pa paravolira nuk' u' a fliis-
te atyre; po veçan nxënëset të ti u'a sgithte
të-gjihta.
35 Edhe mb' atë ditë, si ungrys, u thot' a-
36 tyre, Letë hidhemi përtej. Edhe *nxënësitë*, si
lanë gjindjenë, e marrënë sikundrë ishte ndë
lundrët; edhe të-tjera lundrëza ishinë bashkë
37 me atë. Edhe bënetë një thëllim ere i-math;
edhe valëtë bininë brënda ndë lundrët, kaqë
38 sa ajo tani po mbushej. Edhe ay ishte ndë
të-prapësmet anë të *lundrësë* dyke flejturë

mbi ndënëkresët; edhe e sgjojnë e i thonë,
 39 Mësonjës, s' do të dish se po humbemi? Edhe
 ay ungrit e qërtoj erënë, edhe i tha detit,
 40 Pusho, sbutu. Edhe pushoj era, edhe u bë
 bunac' e-mathe. Pastaj u tha atyre, çfrika-
 41 carë jeni kështu? Si s' kini besë? Edhe ata
 ufrikësuanë me frikë të-mathe, edhe i thoshinë
 njëri tjetrit, Cili vallë është ky, që edhe era
 edhe deti e dëgjonjënë.

Krye 5.

1 Edhe erthnë *nd' anët* të-përtejme të detit,
 2 ndë vëntt të Gadharinjvet. Edhe posa dolli
 nga lundra, për-një-here i dolli përpara nga
 3 varretë një njeri me frymë të-ndyrë, Që kish-
 te të-ndënjuritë ndër varret, edhe asndonjë
 s' muntte t'a lihte as me vargje hekurash;
 4 Sepse shumë herë qe lidhurë me hekura ndër
 këmbë e me vargje hekurash, po ay i kishte
 këputurë vargjet' e hekuravet edhe thyerë he-
 kurat' e këmbëvet; edhe asndonjë s' muntte
 5 t'a sbutte. Edhe gjithënjë, dit' e natë, ishte
 ndëpër varret e ndëpër malet dyke bërtitur
 e dyke copëtuarë vetëhen' e ti me gurë.
 6 Edhe kur pa Jisunë për së largu, ulëshua
 7 me vrap edhe i ufal, Edhe dyke bërtiturë me
 zë të-math thotë: ç' ke ti me mua, o Jisu, i
 bir' i Perëndis' së-lartë? të vë mbë be mbë Perën-
 8 dinë, të mos më mundojsh. Sepse *Jisuj* i thosh-
 9 te, Dil nga njeriu, o frym' e ndyrë. Edhe e

pyeste, Si t'a *thonë* emërinë? Edhe ay upër-
 gjeq e tha, Legjeon m'a *thonë* emërinë, sepse
 10 jemi shumë. Edhe i lutej shumë, që të mos
 e dërgonjë jashtë vëndit.
 11 Edhe atje ndaj malit ishte dyke kulloturë
 12 një tuf' e madhe derrash; Edhe i u lutnë ati
 gjithë djajtë, dyke thënë, Dërgo-na ndër de-
 13 rrat, që të hyjmë ndër ata. Edhe Jisuj për-
 një-here u dha lejë. Edhe frymat' e ndyra
 duallnë, e hynë ndër derrat; edhe tuf' e de-
 rravet udruth prej shkëmbit ndë dett, (edhe
 ishinë afërë dy mijë), edhe umbytnë ndë dett.
 14 Edhe ata që kullotninë derratë iknë, edhe
 dhanë zë ndë qytett e ndëpër arat. Edhe
 duallnë të shohënë ç' është këjo *punë* që u-
 15 bë. Edhe vijnë tek Jisuj, edhe vënë re të
 djallosurinë që pat pasurë legjeoninë dyke
 ndenjurë, e të-veshurë, e të-urtësuarë; edhe
 16 ufrikësuanë. Edhe ata që panë u trëguan'
 atyreve, si gjajti *puna* mbë të djallosurinë,
 17 si edhe për derratë. Edhe zunë t' i lutenë të
 ikënjë nga sinorët' e atyreve.
 18 Edhe kur hynte ay ndë lundrët, ay që pat
 qënë i-djallosurë i lutej të jetë bashkë me
 19 atë. Edhe Jisuj s' e la, po i thotë, Ecë ndë
 shtëpit t' ende te njerëzit' e tu, edhe ep-u zë
 për *gjithë* sa të bëri Zoti edhe të përdëlleu.
 20 Edhe ay iku, edhe zuri të lëçisë nde Dhe-
 kapolë sa i bëri ati Jisuj; edhe të-gjithë çu-
 ditëshinë.

21 Edhe Jisuj si ukapërxye përsëri me lundrë mb'anët të-përtejme, shumë gjindje umbloth tek ay; edhe ay ishte përënë detit.

22 Edhe na tek vjen një nga të-parët' e sinagogjisë, *që e kishte emërinë Jair*; edhe ky

23 kur pa atë, i bje ndër këmbë; Edhe i lutej shumë, dyke thënë, se ime bijëzë është mbë frymët të-pastajme; *të-lutem* të vijsh e të-vësh duartë mbi atë, që të shpëtonjë; edhe dotë

24 rronjë. Edhe ay vate bashkë me atë; edhe shumë gjindje i vininë pas, edhe e shtrëngoninë.

25 Edhe një grua që kishte të-rrjedhurë gjaku dy-mbë-dhjetë vjet, Edhe që kishte hequrë shumë nga shumë shëronjës, edhe që kishte prishurë gjithë ç' kishte pasurë, edhe që s'kishte parë asndonjë dobi, po ishte bërë

27 edhe më keq, Kur dëgjoj për Jisunë, erdhi ndër mest të gjindjesë që prapa, e preku ro-bën' e ati; Sepse thoshte, se edhe rrobat' e

29 ati ndë prekça, dotë shpëtonj. Edhe për-një-here utha burimi i gjakut t' asaj, edhe e ndjeu ndë trupit të saj se ushërua nga smundja. Edhe Jisuj për-një-here, si kupëtoj ndër vetëhe fuqinë që dolli nga ay, ukëthye te

31 gjindja, e thoshte, Kush më preku rrobotë? Edhe nxënësit' e ati i thoshinë, She gjëndjenë se të shtrëngon, edhe thua, Kush më pre-

32 ku? Po ay vinte re përçark që të shohë atë

33 që bëri këtë. Edhe gruaja dyke trëmbur' e

dyke dridhurë, sepse e dinte, se ç' ishte bërë tek ajo, erdhi e i ra *ndër këmbë*, edhe i tha

34 gjithë të-vërtetën. Edhe ay i tha, Bije, besa jote të shpëtoj; ecë ndë paqtim, edhe ij eshëndoshë nga smundja jote.

35 Ay tek po fliste edhe, vijnë nga i-par' i sinagogjisë, dyke thënë, Se jot' bijë vdiq;

36 përse më e mundon mësonjësinë? Po Jisuj posa dëgjoj fjalënë që po flitej, i thotë të-parit të sinagogjisë, Mos kij frikë, vetëmë

37 beso. Edhe s' la asndonjë të vejë prapa bashkë me atë, veç Pjetrinë edhe Jakovinë

38 edhe Joaninë të vëllan' e Jakovit. Edhe vjen ndër shtëpit të të-parit të sinagogjisë, edhe vështron trazyra, e *njerës* që qanin' e ulurininë

39 shumë. Edhe si hyri, u thot' atyre, C' bëni trazyrë e qani? vashëza nukë vdiq, po po fle.

40 Edhe ata e përqeshninë. Po ay, si nxori jash-të të-gjithë, merr me vetëhe t'an' e vashëzësë edhe t'ëmën' edhe ata që ishinë bashkë me atë,

41 edhe hyri *atje* ku ishte dergjurë vashëza. Edhe dyke rrokurë dorën' e vashëzësë, i tha asaj, Talitha kumi, që e-kthyerë do me thënë, Va-

42 shëzë, të them, ngreu. Edhe për-një-here vashëza ungrit, edhe ecënte; sepse ishte dy-mbë-dhjetë vjeç. Edhe uçuditnë me çudi të-madhe.

43 Edhe i porositi shumë të mos e marrë vesh këtë asnjeri; edhe tha t' i epet' asaj të hajë.

Krye 6.

- 1 Edhe dolli andej, edhe erdhi ndë vëntt të ti, edhe nxënësit' e ti i venë pas.
- 2 Edhe kur erdhi e-shëtuna, zuri të mësojë ndë sinagogjit; edhe shumë *veta* kur dëgjoninë, çuditëshinë, e thoshinë, Që ku i *erthnë* këti këto? edhe ç' është këjo dituri që i është dhënë këti, edhe të-këtilla çudira bënë
- 3 nenë nga duart' e ati? Nuk' është ky mjeshturi, i bir' i Marisë, e i vëllaj i Jakovit e i Josiut e i Judhësë e i Simonit? edhe nukë janë të-motrat' e ati këtu ndër ne? Edhe
- 4 skandhaliseshinë mb' atë. Po Jisuj u thoshte atyre, Se nukë ka profit të-panderçim, veç ndë atdhet të ti, edhe ndër njerëzit të ti,
- 5 edhe ndë shtëpit të ti. Edhe s' muntte të bënte atje asndonjë çudi, veç mbë pak të-smurë vuri duartë e i shëroj. Edhe çuditej për pabesërin' e atyre. Edhe shkonte fshat-ravet rrotullë, dyke mësuarë.
- 7 Edhe thirri për anë të dy-mbë-dhjetëtë, edhe zuri t' i dërgonjë dy nga dy; edhe u
- 8 epte pushtet kundrë frymavet të-ndyra. Edhe i porositi ata të mos mbanjnë asgjë udhësë, veç një stap vetëmë; as trajstë, as bukë, as ramë ndë
- 9 brest; Po të jenë mbathurë me sholëza, edhe
- 10 të mos veshnjënë dy rroba. Edhe u thoshte atyre, Mbë ç' shtëpi që të hyni, mbetuni atje
- 11 gjersa të dilni q' andej. Edhe sa *veta* të mos u presënë juve, as të mos u dëgjonjënë juve,

- kur të dilni andej, shkuntni pluhurinë që është përposh këmbëvet t'uaj, për dëshmim mb' ata; me të-vërtetë po u them juve, Më i-duruarshim dotë jetë mundimi ndë Sodhomat e ndë Gomorrat ndë ditët të gjyqit, se
- 12 mb' atë qytet. Edhe ata duallnë e lëçitninë
- 13 që të pendonenë *njerëzitë*; Edhe kërreninë shumë djaj; edhe lyejnë me vaj shumë të-sëmurë edhe i shëroninë.
- 14 Edhe dëgjoj mbreti Irodh, (sepse emër' i ati kishte dalë i-çfaqurë,) edhe thoshte, Se Joani që pagëzonte është ngjallurë nga të-vdekuritë, edhe për andaj fuqit' e qiellit punojnë me anë t' ati. Të-tjerë thoshinë, Se
- 15 ay ishte Ilija. Po të-tjerë thoshinë, Se është
- 16 profit a si një nga profitëritë. Po Irodhi, kur dëgjoj, tha, Se ky është Joani, të-cilit unë i preva kryetë; ay është ngjallurë nga të-vdekuritë.
- 17 Sepse vetë Irodhi dërgoj e zuri Joaninë, edhe e lidhi ndë burk për Irodhiadhënë gruan' e Filipit të vëllat sepse e kishte marrë për
- 18 grua Sepse Joani i thoshte Irodhit, Se s' është e
- 19 udhësë të kesh ti gruan' e t'yt vëllaj. Andaj Irodhiadha e kishte mëri, edhe donte t' a vris-
- 20 te, po nukë muntte. Sepse Irodhi kishte frikë nga Joani, dyke ditur' atë për njeri të-drejtë edhe për shënjt; edhe e ruante, edhe bënte shumë *punë* dyke dëgjuar' atë, edhe me gëzim
- 21 e dëgjonte. Edhe kur erdhi *një* dit' e-mbarë

ndë të-cilët Irodhi u bëri darkë për ditën' e të-lindurit të ti të-mëdhenjvet të ti e krye-
 22 miësve e të-parëvet të Galileës, Edhe hyri e bij' e Irodhiadhësë, e kërceu, edhe i pëlqeu Irodhit edhe atyreve që ishinë ndënjyrë bashkë ndë më-sallët, mbreti i tha vashëzësë, Lup-më ç' të du-
 23 ash, edhe dotë t'a ap. Edhe i bëri be asaj, Se çdo që të më lypësh dotë t'a ap, gjer mbë
 24 gjysmën' e mbretërisë s'ime. Edhe ajo dolli e i tha s' ëmësë, Ç' të lypënj? Edhe ajo tha,
 25 Kryet' e Joan Pagëzorit. Edhe ajo për-një-herë hyri me nxitim te mbreti, e lypi, dyke thënë, Dya të më apç tani ndë talure
 26 kryet' e Joan Pagëzorit. Edhe mbreti u hidhë-rua fort, po për betë që kishte bërë, edhe për ata që ishinë ndënjurë bashkë *me atë*
 ndë më-sallët, nukë deshi t'j'a hedhë poshtë
 27 kërkimnë. Edhe për-një-herë mbreti dërgoj një trim, edhe urdhëroj të bihetë kryet' e ati.
 28 Edhe ay vate, e i preu kryetë ndë burkt; edhe e pruri kryet' e ati mbë talyre, edhe j'a dha vashëzësë; edhe vashëza j'a dha s'
 29 ëmësë. Edhe nxënësit' e ati, kur dëgjuanë, erthnë, edhe ngritnë trupin' e ati, edhe e vunë ndë varr.
 30 Edhe apostojtë mblidhenë te Jisuj, edhe i rrëfyanë të-giitha, edhe sa bënë, edhe sa
 31 mësuënë. Edhe u tha atyre, Ejani ju vetë veçanë ndë një vënt të-shkretë, edhe prëhi pak; sepse ishinë shumë ata qe vinin' e

shkoninë, edhe as për të ngrënë s'kishinë
 32 kohë. Edhe *ata* vatnë me lundrë ndë një vënt të-shkretë veçanë.
 33 Edhe (gindja) pan' ata dyke shkuarë, edhe shumë *veta* e njohne; edhe mbë këmbë nga gjithë qytetetë usulnë atje, edhe arritnë më përpara se ata, edhe umblohnë për an' ati.
 34 Edhe Jisuj, kur dolli, pa shumë gjindje edhe j'udhëmp për ata, sepse ishinë si dhën që s' kanë bari; edhe zuri t' i mësonjë shumë.
 35 Edhe tani me-qënë-që kishte shkuarë shumë koha i uafëruan' ati nxënësit' e i thonë, se vëndi është i-shkretë edhe tani koha
 36 ka shkuarë shumë; Lësho ata, që të venë ndëpër arat e ndëpër fshatrat rrotullë, e të blenë bukë për vetëhen' e tyre; sepse s' kanë
 37 se ç' të hanë. Po ay upërgjeq e u tha atyre, Ep-u-ni juve atyre të hanë. Edhe *ata* i thonë, Të vemi e të blemë dy qint dinarë bukë, e t'
 38 u apëm' atyre të hanë? Edhe ay u thot' atyre, Sa bukë kini? shkoni e shihni. Edhe si *van'*
 39 e panë, i thonë, Pesë, edhe dy pishqe. Edhe ay urdhëroj ata t' i vënë ata të rrinë të gjithë
 40 truveza truveza përmi bart të-njomë. Edhe ata ndënjnë togje togje, nga një qint e nga
 41 pesë-dhjetë. Edhe ay si mori të pesë bukët' e të dy pishqetë, ngriti sytë ndë qiell, e bekoj, edhe theu bukëtë edhe u'a dha nxënës-
 42 të dy pishqetë u a ndau të-gjithëve. Edhe të-

- 43 gjithë hëngrrë e unginë. Edhe ngriftnë dy-
 mbë-dhjetë kofinë plot me copëra, edhe nga
 44 pishqetë. Edhe ata që hëngrrë bukëtë ishinë
 si ndonja pesë mijë burra.
- 45 Edhe për-një-here shtrëngoj nxënësit' e
 ti të hyjnë në lundrë, edhe të venë më parë
 se ay mb' at' anë në Vithsaida, gjersa ay
 46 të lëshonte gjindjenë. Edhe si i lëshoj, vate
 në malt të faletë.
- 47 Edhe kur ungrys, lundra ish në mest të
 48 detit, edhe ay vetëmë mbi tokët. Edhe pa ata
 që po mndoneshinë mbë të-vozturit; sepse
 era ishte kundrë atyre; edhe mbë të-katrëtë-
 në ruajtje të natësë vjen tek ata, dyke ecurë
 49 mbi dett; edhe donte t' i kapërxente. Po ata
 kur pan' atë që po ecënte mbi dett, pandeh-
 50 në, se ishte hije, edhe bërtitnë. Sepse të-gjithë
 e panë, edhe udrothnë. Edhe për-një-here foli
 bashkë me ata, e u thot' atyre, Kini zëmërë;
 unë jam, mos ufrikësoni. Edhe hipi tek ata
 51 në lundrë; edhe era pushoj. Edhe me ve-
 tëhen' e tyre habiteshinë fort tepërë, edhe
 52 çuditeshinë. Sepse nuk' e muarnë vesh nga
 bnkëtë; sepse zëmër' e atyre ish e-ashpëruarë.
- 53 Edhe si ukapërxyenë, erthnë në dhet
 Gjennisaret, edhe hothnë hekurë në liman.
- 54 Edhe ata kur duallnë nga lundra, për-një-
 55 here e njohinë, Edhe uturnë ndëpër gjith' ata
 vënde rrotullë, e zunë të bininë mbi shtratëra
 ata që kishinë keq atje ku dëqjoninë se është.

- 56 Edhe kudo që hynte ndër fshatëra, a ndër
 qytete, a ndër ara, vininë të-smurëtë ndëpër
 tregjet, edhe i luteshinë të preknjënë vetëmë
 pëqin' e rrobës' s' ati; edhe gjithë sa e prek-
 ninë, shëroneshinë.

Krye 7.

- 1 Atëhere mbliidhenë tek ay Farisenjtë, edhe
 disa nga shkronjësitë, që kishin' ardhurë nga
 2 Jerusalmi. Edhe kur panë, se disa nga nxë-
 nësit' e ati haninë bukë me duar të-fëlliqura,
 3 do-me-thënë të-palara, i përfolnë. (Sepse Fa-
 risenjt' edhe gjithë Judhenjtë, ndë mos laf-
 shinë duartë gjer në bryllt, nukë hanë, sepse
 4 mbajnë fjalënë qe u kanë lënë pleqtë; Edhe *kur
 kthenenë* nga tregu, ndë mos u lafshinë, nukë
 hanë; edhe shumë të-tjera ka që kanë marrë
 për të mbajturë, *si të-lara* potirësh, e limash,
 5 e enësh të-ramta, e shtratërash.) Pasandaj Fa-
 risenjt' e shkronjësit' e pyesënë, përse nxë-
 nësit' e tu nuk' ecëjnë sipas fjalëveve që kanë
 lënë pleqtë, po me duar të-palara hanë bukë?
 6 Po ay upërgjiej e u tha atyre, Se mirë
 profitepsi Isaia për ju ipokritëritë, sikundrë
 është shkruarë, „Ky llaus me buzëtë më nde-
 ron, po zëmër' e atyre është lark prej meje;
 7 Edhe kot më nderonjënë, dyke mësuarë më-
 8 sime porosi njerëzish.“ Sepse kini lënë poro-
 sin' e Perëndisë, e mbani fjalëtë që kanë

lënë njerëzitë, të-lara limash e potirësh, edhe bëni shumë të-tjera të-tilla si këto.

- 9 Edhe u thosh atyre, Mirë e hithni poshtë, poroshin' e Perëndisë, që të mbani fjalënë që
10 kini lënë. Sepse Moisiu ka thënë, „Ndero t' ët atë e t' ët ëmë;“ edhe, „kush flet keq për t' an' a për t' ëmënë pa fjalë të vritetë.“
11 Po ju thoni, Njeriu ndë i thëntë t' et a s' ë-mësë, kurban, që do me thënë dhurëti, është çdo e-mirë që dotë shohç prej meje, *është*
12 *mjaft*; Edhe s' e lini më t' i bënë asgjë t'
13 et a s' ëmësë, Edhe shkeli fjalën' e Perëndisë për fjalënë t' uaj që kini lënë; edhe bëni shumë të-tilla *punë* si këto.
14 Edhe si thirri për-anë gjithë gjindjenë, u thosh atyre, Dëgjo-më-ni të-gjithë, edhe merni
15 vesh; S' ka asgjë që përjashta njeriut që hyn tek ay që munt t'a ndynjë, po ato që dalënë
16 prej ati, ato janë që e ndynjënë njerinë. Ay që ka veshë për të dëgjuarë letë dëgjonjë.
17 Edhe kur hyri ndë *një* shtëpi prej gjindjesë, e pyesninë nxënësit' e ti për paravolinë.
18 Edhe *ay* u tha atyre, Kështu edhe ju jini të-pamarrë vesh? s' merrni vesh se çdo gjë që
i hyn njeriut që përjashta nukë munt t'a ndy-
19 një? Sepse nukë hyn ndë zëmërët t' ati, po ndë barkut; edhe del ndë të-dalët, dykë që-
20 ruarë gjithë të-ngrënatë. Po thoshte, se ç'
21 del nga njeriu, ajo ndyn njerinë. Sepse që përbrënda nga zëmër' e njerësvet dalënë men-

- 22 dimet' e-liq, ndyrësira, kurvërira, vrasje, vjedhje, lakmime, ligësira, kobin, tepërë-ndyrësi, të-shikuarë me sy të-lik, vllasfimi, madhë-
23 shti, marrësi. Gjithë këto të-liga që përbrënda dalënë, edhe ndynjënë njerinë.
24 Edhe ungrit prej andej, e vate ndë sinorët të Tyres' e të Sidhonësë, edhe si hyri ndë një shtëpi, nukë deshi t'a marrë vesh asnjeri; po s' mundi të fshihetë.
25 Sepse një grua, së-cilësë e bijëza kishte frymë të-ndyrë, kur dëgjoj për atë, erdhi e
26 i ra ndër këmbë. Edhe gruaja ishte greke, Syrofinike nga kombi; edhe i lutej të kërrenjë
27 një djallinë prej së bijësë. Po Jisuj i tha asaj, Le të të nginjenë më përpara djemtë; sepse s' është mirë të marrë ndonjë bukën' e djemvet, edhe t' u' a hedhë këlyshvet *të*
28 *qënvet*. Po ajo upërgjeq e i tha, Po, Zot, *po* edhe këlushëtë përposh trvezësë hanë nga
29 thërrimet' e çunavet të-vegjëlë. Edhe ay i tha asaj, për këtë fjalë shko; djalli doli nga jot'
30 bijë. Edhe *ajo* kur vate ndë shtëpit të saj, gjeti të bijënë rënë mbë shtratt edhe djallinë të-kërryerë.
31 Edhe përsëri doli nga sinorët' e Syrës' e të Sidhonësë, edhe erdhi ndaj detit të Galilësë ndëpër mest të sinorëvet të Dhekapolësë.
32 Edhe i sjellënë një të-shurdhërë belbacuk,
33 edhe i lutenë të vërë dorënë mbi atë. Edhe ay e mori prej gjindjesë veçanë, edhe vuri

- 33 edhe i lutenë të vërë dorënë mbi atë. Edhe ay e mori prej gjindjesë veçan, edhe vuri gishtërit' e ti ndë veshët t' ati, edhe si pshty-
 34 ti, i preku gjuhënë; Edhe si ngriti sytë ndë qiellit, psherëtiti, edhe i thotë ati, Effatha, që
 35 do me thënë, Hapu. Edhe për-një-here uhap-në veshët' e ati, edhe usgith të-lidhurit' e gjuhës' s' ati, edhe fliste drejt.
 36 Edhe i porositi të mos i thonë asneriu; po sa më *tepërë* i porositte ay, kaqë më tepërë ata e lëçitninë. Edhe çuditëshinë fort tepërë e thoshinë, Mirë i ka bërë të-gjitha; edhe të-shurdhërit' i bën të dëgjonjënë, edhe memecëtë të flasënë.

Krye 8.

- 1 Nd' ato dit, passi ishte shumë gjindje, edhe s' kishinë se ç' të haninë, *Jisuj* thërriti
 2 përanë nxënësit' e ti, e u thot' atyre, Më dhëmbetë për gjindjenë, sepse tani *janë* tri dit që rrinë përanë meje, edhe s' kanë se
 3 ç' të hanë; Edhe ndë i lëshofsha të-pangrënë për ndë shtëpit të tyre, dotë këputenë mb' udhë; sepse ca nga ata kanë ardhurë prej
 4 së-larqu. Edhe nxënësit' e ati i upërgjeqnë, Nga dotë muntnjë njeriu t' i nginjë këta me
 5 bukë këtu ndë shkretëtirët? Edhe ay i pyeti,
 6 Sa bukë kini? Edhe ata i thanë, Shtatë. Edhe porositi gjindjenë të unjenë përdhe; edhe si mori të shtatë bukëtë, e ufal ndersë, i theu,

- edhe u' a dha nxënësvet të ti, që t' i vënë përpara *gjindjesë*; edhe *ata* i vunë përpara
 7 gjindjesë. Edhe kishinë pak pishqe të-vegjëlë; edhe si bekoj, tha të vënë përpara edhe ata.
 8 Edhe hëngrë e unginjë; Edhe ngritinë tepë-
 9 rica copash, shtatë çporta. Edhe ata që hëngrë ishinë sinja katrë mijë *veta*; pasandaj i lëshoj ata.
 10 Edhe për-një-here hyri ndë lundrët bashkë me nxënësit' e ti, edhe erdhi nd' anët Dhallmanutha.
 11 Edhe duallë Farisenjtë, e zunë të bishtonjënë me atë, edhe të lypnjënë nga ay shë-
 12 një prej qiellit, dyke ngar' atë. Po ay si psherëtiti ndë shpirt të ti, thotë, Përse lypën shënjë ky bres? me të-vërtetë po u them juve, Nukë dot' i epetë shënjë këti brezi.
 13 Edhe si i la, hyri përsëri ndë lundrët, e shkoj nd' *anët* të-përtejme.
 14 Edhe ata harruanë të marrënë bukë, edhe s' kishinë me vetëhe ndë lundrët veç një
 15 bukë. Edhe ay i porosiste, dyke thënë, Shikoni, ruhi nga brumi i Farisenjvet edhe nga
 16 brumi i Irodhit. Edhe *ata* mendonëshinë ndër mest të tyre, dyke thënë, Se s' kemi bukë.
 17 Edhe Jisuj si e kupëtoj, u tha atyre, Ç' mendoneni, se s' keni bukë? edhe s' merrni vesh as kupëtoni? edhe po t' ashpërë e keni
 18 zëmërnë t' uaj? Dyke pasurë sy, nukë shihni? edhe dyke pasurë veshë, nukë dëgjon?

- bukëtë mbë të pesë mijët, sa kofinë plot me copëra ngrittë? I thonë, Dy-mbë-dhjetë.
- 20 Edhe kur të shtatë *bukëtë* ndë të katër mijët, sa çporta plot me copëra ngrittë? Edhe
- 21 ata thanë, Shtatë. Edhe u thoshte atyre, Qysh nukë kupëtoni?
- 22 Pasandaj vjen ndë Vithsaidha; edhe i bjenë *një* të-verbërë, edhe i lutenë t' a preknjë.
- 23 Edhe si e preku prej dore të-verbërinë, e nxori jashtë fshatit; edhe si pshtyti ndër syt t' ati, vuri duartë mbi atë, edhe e pyeste, ndë
- 24 sheh gjë. Edhe ay si hapi sytë, tha, Shoh
- 25 njerëzitë se ecëjnë posi drurë. Pasandaj përsëri vuri duartë mbi syt' t' ati, edhe e bëri atë të hapnjë sytë, edhe u shërua, edhe shih-te kthjellëtë të-gjitha. Edhe e dërgoj ndë shtëpit t' ati, dyke thënë, As ndë fshat të hyjsh, as t' j' a thuash këtë njeriu ndë fshat.
- 27 Pasandaj dolli Jisuj edhe nxënësit' e ti ndëpër fshatrat të Qesaris' së Filipit; edhe udhësë pyeste nxënësit' e ti, dyke thënë atyre, Cili thonë njerëzitë se jam unë? Edhe
- 28 ata i upërgjeqnë, Joan Pagëzori; edhe të-tjerë *thonë*, Ilija; edhe të-tjerë, një nga profitëritë.
- 29 Edhe ay u thot' atyre, Po ju cili thoni
- 30 se jam unë? Edhe Pjetri upërgjeq, e i thotë, Ti je Krishti. Edhe i porositi ata ashpë-rë që të mos i thonë njëriu për atë.
- 31 Edhe zuri t' i mësonjë ata, se i bir' i njeriut duhetë të pësonjë shumë, edhe të mos

- pëlqenetë nga pleqt' e nga kryepriftëritë e nga shkronjësitë, edhe të vritetë, edhe pas tri ditsh të ngjalletë. Edhe e fliste fjalënë
- 32 faqeza. Edhe Pjetri e mori veçanë, e zuri t' 33 a qërtonjë. Po ay si ukthye e vuri re nxënësit' e ti, qërtoj Pjetrinë, dyke thënë, Ikë prej meje, Satana; sepse s'ke ndër mënt punët' e Perëndisë, po punët' e njerësvet.
- 34 Edhe si thirri përanë gjindjenë bashkë me nxënësit' e ti, u tha atyre, Kush të dojë të vinjë prapa meje, letë mohonjë vetëhen' e ti, edhe letë ngrerë kryqin' e ti, edhe letë më
- 35 vinje pas. Sepse kush të dojë të shpëtonjë jetën' e ti, dot' a humbasë; po kush të humbasë jetën' e ti për punë t' ime edhe të un-
- 36 gjillit, ky dot' a shpëtonjë. Sepse ç' dobi dotë ketë njeriu, ndë fitoftë gjithë botënë, edhe
- 37 të dëmtonjë shpirtin e ti? Apo ç' dotë apë
- 38 njeriu për këmbyerje të shpirtit të ti? Sepse cilitdo që t' i vinjë turp për mua edhe për fjalët' e-mia mbë këtë bres kurvar edhe fajtuar, edhe të birit të njeriut dot' i vinjë turp për atë, kur të vinjë ndë lavdit të t' Et bashkë me ëngjëjt' e-shënjtëruarë.

Krye 9

- 1 Edhe u thosh atyre, Me të-vërtetë po uthem juve, se janë disa prej këtyre që rrinë këtu, që nukë dotë ngjëronjë vdekje, gjersa të shohë-në mbretërin' e Perëndisë t' ardhurë me fuqi.

- 2 Edhe pas gjashtë ditsh Jisuj merr Pjetrin' e Jakovin' e Joaninë, edhe i hipën ata vetëmë mbë një mal të-lartë veçanë; edhe ndë-
 3 rroj fytyrënë përpara atyre. Edhe rrobat' e ati ubënë të-çkëlqyera të-bardha fort posi dëbora, t' atilla që robësbardhës mbi dhet
 4 s' munt t' i sbarthnjë kështu. Edhe u duk atyre Ilia bashkë me Moisinë; edhe ishinë dy-
 5 ke folurë bashkë me Jisunë. Edhe Pjetri upërgjeq e i tha Jisujt, Ravvi, mir' është të jemi ne këtu; edhe letë bëjmë tri tenda, një për ty, edhe një për Moisinë, edhe një
 6 për Ilinë. Sepse s' dinte se ç' të fliste, sepse 7 ishinë tremburë keq. Edhe një re i mbuloj, edhe erdhi një zë prej resë dyke thënë, Ky
 8 është biri im i-dashurë, ati i dëgjoni. Edhe befas kur vunë re perqark, s' panë më asndonjë, po Jisunë vetëmë bashkë me vetëhen' e tyre.
 9 Edhe ata tek ishinë dyke sbriturë nga mali, i porositi ata të mos i tregonjën' as njeriut sa panë, veç kur të ngjalletë i Bir' i njeriut prej së-vdekurish. Edhe ata e ruajtne fjallënë *nder vetëhe*, dyke bishëtuarë njëri me tjatrinë, Ç' është këta të-ngjallurë prej së-vdekurish.
 11 Edhe e pyesnin' atë, dyke thënë, Përse thone shkronjësitë, se duhetë të vinjë më
 12 përpara Ilia? Edhe ay upërgjeq e u tha atyre, Ilia vjen më përpara, edhe vë mbë vënt

- të-gjitha *punëratë*; edhe si është shkruarë për të birin' e njeriut se duhetë të pësonjë shu-
 13 më, edhe të çnderonetë. Po u them juve, Se edhe Ilia erdhi, edhe *se* i bënë sa deshnë, sikundrë është shkruarë për atë.
 14 Edhe kur erdhi te nxënësitë, pa shumë gjindje rreth atyreve, edhe shkronjësitë dyke
 15 bishëtuarë me ata. Edhe për-një-here gjithë gjindja, kur e pan' atë, uhabitnë, edhe dyke
 16 nxituar' e përshëndoshninë. Edhe ay pyeti 17 shkronjësitë, Ç' bishëtoni me ata? Edhe një prej gjindjesë upërgjeq, e tha, Prura te ti t' im
 18 bir që ka frymë të-pagojë. Edhe kudo t' a zërë, e heth poshtë; edhe shkumbëzon, e kërcëllin dhëmbët' e ti, edhe thahetë; edhe u thashë nxënëset të tu t' a kërrenjënë, po nu-
 19 kë muntne. Edhe ay i upërgjeq e tha, O bres i-pabesë, gjer kur dotë jem bashkë me ju? gjer kur dot' u duronj juve? sill-e-ni atë
 20 tek unë. Edhe e prunë tek ay; edhe kur pa atë, për-një-here fryma e çkleu; edhe ra përdhe, edhe rungullisej dyke shkumbëzuarë.
 21 Edhe ay pyeti t' anë, sa kohë ka që kur se i gjau këjo? Edhe ay, tha, Që kur se ishte djal'
 22 i-vogëlë. Edhe shumë herë e hodhi edhe ndë zjarr edhe nd' ujëra, që t' a humbasë; po ndë munt të *bësh* gjë, letë të dhëmbetë për
 23 ne edhe ndih-na. Edhe Jisuj i tha këtë, Ndë munt të besojsh, të-gjitha *janë* të-mundura
 24 për atë që beson, Edhe për-një-here i at' i

- djalit të-vogëlë thëriti me lot, dyke thënë,
- 25 Besonj, Zot; ndihni pabesërisë s' ime. Edhe Jisuj kur pa, se po rrudhetë gjindje, qërtoj frymën' e-ndyrë, dyke i thënë, Frym e-pagojë edhe e-shurdhërë, unë të urdhëronj, dil nga
- 26 ay, edhe mos hyjsh më tek ay. Edhe *Fryma* dyke bërtitur' e dyke shklyer' atë fort, dolli; edhe *djali* ubë posi i-vdekurë, kaqe sa shu-
- 27 më *veta* thoshinë se vdiq. Edhe Jisuj e kapi prej dore, edhe e ngriti; edhe u ngrit.
- 28 Edhe kur hyri ndë *një* shtëpi, nxënësit' e ti e pyesninë veçanë, Përse nukë muntmë
- 29 neve t'a kërrejme. Edhe *ay* u tha atyre, ky farë kombi s' munt të dalë *me tjetërë gjë*, veç me të-falur'e me agjërim.
- 30 Edhe si dualinë andej, shkoninë ndëpër Galilet, edhe s' donte t'a marrë vesh njeri.
- 31 Sepse mësonte nxënësit' e ti, e u thosh atyre, se i Bir'i njerlut epetë ndër duar të njerësve, edhe do t'a vrasënë, edhe si të
- 32 vritetë, të-tretënë ditë dotë ngjalletë. Po ata nuk' e kupëtoninë fjalënë, edhe kishinë frikë t'a pyesënë.
- 33 Edhe erdhi ndë Kapernaum; edhe kur hyri ndë shtëpit, pueste ata, Ç' mendoneshitë
- 34 udhësë ndë mest t' uaj? Po ata s' bëninë zë; sepse udhësë flisninë ndë mest të tyre,
- 35 cili është m' i-math. Edhe si ndënji thirri të dy-mbë-dhjetëtë, edhe u thot' atyre, kush të dojë të jet' i-parë, dotë jetë i-prapësm i

- të-gjithëve, edhe shërbëtuar i të-gjithëve.
- 36 Edhe mori një djallë të-vogëlë, edhe e qëndroj ndë mest t' atyreve, edhe si e mori
- 37 ndë krah, u tha atyre, Kush të presë një nga të-këtitillët djem të-vegjëlë mb' emërit t' im, ka priturë mua; edhe kush të presë mua, s' ka priturë mua, po atë që më ka dërguarë.
- 38 Edhe Joani i upërgjeq, dyke thënë, Mësonjës, pamë një *njeri* që kërren djaj mb' emërit t' ënt, i-cili nukë na vjen pas; edhe e
- 39 ndalmë sepse nukë na vjen pas. Po Jisuj tha, Mos e ndalni, sepse s' ka asndonjë i-cili dotë bënjë çudira mb' emërit t' im, edhe dote muntnjë për-një-here të flasë keq për mua;
- 40 Sepstë kush nuk është kundrë nesh, është
- 41 bashkë me ne. Sepse kush t' u apë juve një potir ujë mb' emërit t' im, sepse jeni të Krishtit, me të vërtetë po u them juve, se nukë
- 42 do t'a humbasë pagën' e ti; Edhe kush të skandalisnjë një nga këta të-vegjëlët që më besojnë, është më mirë për atë, ndë i ulithtë një gur mulliri ndë qafët të ti, edhe të hidhetë ndë dett.
- 43 Edhe ndë të skandalistë dora jote, pre-e; është më mirë për ty të hynjë, ndë jetët dorac, se dyke pasurë të dy duartë të shkojsh ndë
- 44 gjehenët, ndë zjarrit të-pashuarë, Ku „krimb' i atyre s' ka të-mbaruarë, edhe zjarri s' ka
- 45 të-shuarë“. Edhe ndë të skandalistë ty këmba

jote, pre-e; sepse është më mirë për ty të
hynjç ndë jetët i-çalë, se duke pasurë të dy
këmbëtë të hidhesh ndë gjehenët, ndë zjarrt
46 të-pashuarë, Ku „krimb’i atyre s’ka të-mba-
47 ruarë, edhe zjarri s’ka të-shuarë.“ Edhe ndë
të skandhalistë syri yt, nzir-e; është më mi-
rë për ty të hynjç me një sy ndë mbretërit
të Perëndisë, se dyke pasurë dy sy të hidhesh
48 ndë gjehenët të zjarrit, Ku „krimb’i atyre s’ka
të-mbaruarë, edhe zjarri s’ka të-shuarë.“
49 Sepse çdo njeri me zjarr dotë kripetë, edhe
50 çdo kurban me kripë dotë kripetë. E-mirë
është kripa, po ndë ubëftë kripa ë-pashëllir-
shime, me se do t’ a ndreqni? Kini kripë
ndë vetëhet t’uaj, edhe kini paqtim njeri
me tjatrinë.

Krye 10

- 1 Edhe si ungrit andej, vjen ndë sinorët
të Judhesë, më anë të-përtejme të Jordhanit,
edhe prapë gjindje mblidhenë përan’ati,
edhe sikundrë e kishte zakon, përsëri i
mësonte.
- 2 Edhe si i erdhë përanë Farisenjtë, e
pyetnë dyke ngar’atë, A është e udhësë burri
3 t’ a lëshonjë gruanë? Edhe ay upërgjeq e u
tha atyre, Ç’u ka porositurë juve Moisiu?
4 Edhe ata thanë, Moisiu dha lejë të shkruanjë
5 kartë ndarjeje edhe t’ a lëshonjë. Edhe Jisuj
upërgjeq e u tha atyre, Për zëmërnë t’ uaj

- 6 të-ashpërë u shkroj juve këtë porosi; Po që
ndë kryet të krijesësë mashkull edhe femërë
7 i bëri ata Perëndia. „Për këtë punë njeriu
8 dotë lërë t’ an’ e t’ ëmënë, Edhe dotë ngjitetë
pas gruas’ së tij, edhe dotë jenë të-dy ndë
një mish;“ kaqë sa nukë janë më dy, po një
9 mish. Atë pra që Perëndia e bëri par, njeriu
letë mos e ndanjë.
- 10 Edhe ndë shtëpit përsëri e pyetnë nxë-
11 nësit’ e ti për gjithatë gjë. Edhe ay u thot
atyre, Kush të lëshonjë gruan’ e ti e^o të mar-
12 tonetë me tjatërë, kurvëron mb’ atë. Edhe
gruaja ndë lëshoftë burrin’ e saj, edhe të
martonetë me tjatërë, kurvëron.
- 13 Edhe i prunë ati çuna të-vegjëlë, që t’ i
preknjë; edhe nxënësit’ i qërtonin’ ata që i
14 bininë. Po Jisuj kur pa, uzëmërua, edhe u
tha atyre, Lini çunat’ e-vegjëlë të vijnë tek
unë, edhe mos i dalni; sepse e të-këtililëvet
15 është mbretëri’ e Perëndisë. Me të-vërtetë po
u them juve, Kush të mos presë mbretërin’ e
Perëndisë posi një çun i-vogëlë nukë dotë
16 hynjë nd’ atë. Edhe si i mori ndë kraih, vuri
duartë mbi ata, edhe i bekoj.
- 17 Edhe tek po dilte mb’ udhë, një njeri u
lëshua me vrap, edhe ra mbë gjunj përpara
ati, edhe e pyeste, Mësonjës i-mirë, ç’ të bënj
18 që të trashëgonj jetën’ e-përtjetëshme? Edhe
Jisuj i tha, Ç’ më thua i-mirë? Asndonjë s’
19 është i-mirë, përveç një, Perëndia. Porositë i

- di, „Mos kurvërosh; Mos vraç; Mos vjethç; Mos apç dëshmim të-rrëm; Mos bëjsh dëm;
- 20 Ndero t'ët atë e t'ët ëmë“. Edhe ay i upërgjeq, e i tha, Mësonjës, këto i kam ruajturë
- 21 që mbë të-rit t' im. Edhe Jisuj shtyri sytë mb' atë, edhe e deshi, edhe i tha, Një gjë të mungon, shko e shit sa ke, edhe ep-u'a të-vo-begjet, edhe dotë kesh thesar ndë qiell, edhe
- 22 eja, ngri kryqnë, e ecë pas meje. Po ati i erdhi liksht për fjalënë, edhe iku i-hidhëruarë,*se kishte gjë shumë.
- 23 Edhe Jisuj si hodhi sytë përquark, u tha nxënëset të ti, Sa me të-vështirë dotë hynjë-në ndë mbretërit të Perëndisë ata që kanë
- 24 pasje! Edhe nxënësitë tmeroneshinë për fjalët' e ati. Po Jisuj përsëri upërgjeq e u tha atyre, Djem, sa e-vështirë gjë është të hynjë-në ndë mbretërit të Perëndisë ata që be-sonenë mbë pasjet! Më kollaj është të shkonjë kamilla ndëpër vërët të gjilpërësë, se i-pasuri të hynjë ndë mbretërit të Perëndisë.
- 26 Edhe ata tepërë çuditëshinë, dyke thënë me vetëhen' e tyre, Edhe cili munt të shpëtonjë?
- 27 Edhe Jisuj si shtyri sytë mb' ata, tha, Te njerëzitë është punë e-pamundurë, po jo te Perëndia; sepse të-gjitha janë të-mundura te Perëndia.
- 28 Edhe Pjetri zuri t'i thotë, Na neve tek
- 29 lamë të-gjitha, edhe erthmë pas teje. Edhe Jisuj upërgjeq, e tha, Me të-vërtetë po u them

- juve, se s' është as ndonjë, që la shtëpi, a vëllezër, a motra, a atë, a mëmë, a grua, a
- 30 djem, a ara, për punë t' ime edhe t' ungjillit, që të mos marrë për një një qint tani ndë këtë kohë, shtëpi, e vëllezër, e motra, e mëmë, e bij, e ara, bashkë me të-ndjekura, edhe ndë
- 31 jetët që vjen jetë të-përjetëshme. Po shumë të-parë dotë jenë të-prapësm, edhe të-prapëshm të-parë.
- 32 Edhe ishinë mb' udhët dyke hipurë ndë Jerusalem; edhe Jisuj ishte dyke shkuarë përpara atyreve, edhe ata çuditëshinë, edhe vininë prapa dyke pasurë frikë. Edhe ay mori përënë përsëri të dy-mbë-dhjetëtë, edhe zuri
- 33 t' u thotë ato punë që dot' i gjanin' ati, Se na tek po hipëjmë ndë Jerusalem, edhe i Bir'i njeriut dotë epetë ndër duart të kryepri-tërvet edhe të shkronjëset, edhe dota gjykonjë-në për vdekje, edhe dot' a apënë ndër
- 34 duart të kombevet; Edhe dot' a përqeshnjënë, edhe dot' a rrahënë, edhe dot' a pshtynjë-në, edhe dot' a vrasënë, edhe të-tretënë ditë dotë ngjalletë.
- 35 Edhe atëhere vijnë tek ay Jakovi edhe Joani, të bijt' e Zevedheut, dyke thënë, Mësonjës, duamë të na bejsh atë që të lypëjmë.
- 36 Edhe ay u tha atyre, Ç' doni t' u bënj unë
- 37 juve? Edhe ata i thanë, Ep-na të rrimë, një-ri prej së-djathtësë s' ate, edhe njëri prej së-
- 38 mëngjërësë s' ate, ndë lavdit t' ende. Po Jisuj

- u tha atyre, S' dini se ç' lypni; a muntni të pini potirrë që pi unë, edhe të pagëzoneni
- 39 me pagëzimnë që pagëzonem unë? Edhe ata i thanë, Muntmë. Edhe Jisuj u tha atyre, potirrë, që pi unë, dot' a pini, edhe me pagëzimnë, që pagëzonem unë, dotë pagëzoheni; Po të rrini prej së-djathtësë s' ime e prej së-mëngjërësë s' ime, nuk' është puna ime t'a ap, po *dot' u epetë atyre*, për të-cilëtë është bërë gati.
- 41 Edhe të dhjetëtë kur dëgjuanë, zunë të zëmëronenë për Jakovin' edhe për Joani në.
- 42 Po Jisuj si i thirri për anë, u thot' atyre, E dini se ata që numëronenë *për* të-parë të kombevet me shtrëngim zotërojnë mbi ata, edhe të-mëdhenjt' e atyre me pushtet i urdhërojn' ata. Po nukë dotë jetë kështu ndër ju, po kush të dojë të bënetë i-math ndër ju,
- 44 dotë jetë shërbëtori juaj; Edhe kush të dojë prej jush të bënet' i-parë, dotë jetë shërbëtuar i të-gjithëve; Sepse edhe i Bir' i njeriut nuk' erdhi të shërbenetë, po të shërbenjë, edhe të apë jetën' e ti çpërblim për shumë *veta*.
- 46 Pastaj vijnë ndë Jeriho; edhe tek dilte prej Jerihosë ay edhe nxënësit' e ti, edhe mjaft gjindje, Vartimeu i-verbërë, i bir' i Timeut, rrinte për an' udhësë dyke lypurë:
- 47 Edhe kur dëgjoj, se është Jisu Nazoreasi, zu të bërtasë e të thotë, Jisu, i bir' i Davidhit,

- 48 përdëlle-më. Edhe shumë veta e qërtoninë, që të mos bënjë zë; po ay shumë më tepër
- 49 bërtiste, I bir' i Davidhit, përdëlle-më. Edhe Jisuj qëndroj, e tha të thërritetë; edhe *ata* e thërresënë të-verbërinë, e i thonë, Merr
- 50 zëmërë, ngreu; po të thërret. Edhe ay si hodi dhi rrobën' e ti, ungrit, e erdhi te Jisuj. Edhe Jisuj upërgjoeq, e i thotë, Ç' do të të bënj?
- Edhe i-verbëri i tha, Ravvuni, të hap sytë.
- 52 Edhe Jisuj i tha, Shko; besa jote të shpëtoj. Edhe për-një-here hapi sytë, edhe vinte pas Jisujt mb' udhët.

Krye 11.

- 1 Edhe kur afëronenë ndë Jerusolim, ndë Vithfagji edhe ndë Vithani, ndaj malit të
- 2 Ullinjet, dërgoj dy nga nxënësit' e ti, edhe u thot' atyre, Shkoni ndë fshat *që është* kundruell jush, edhe për-një-here posa të hyni mb' atë, dotë gjeni një pulisht lldhurë, të-cilit s' i ka hipurë asndonjë prej njerëzet;
- 3 sgjidh-e-ni edhe sill-e-ni; Edhe ndë u thënë ndonjë juve, Ç' bëni kështu? thoni, se Zoti ka nevojë për atë; edhe për-një-here dot' a dërgonjë këtu.
- 4 Edhe *ata* vanë, edhe gjetnë pulishtinë lldhurë ndaj derësë jashtë ndë udhët; edhe e
- 5 sgidhnjënë. Edhe disa nga ata që rrininë atje u thoshinë atyre, Ç' bëni kështu që sgithni
- 6 pulishtinë? Edhe u thon' atyre sikundrë i pat

- 7 porositurë Jisuj; edhe *ata* e lanë. Edhe prunë pulishtinë te Jisuj, edhe vunë rrobat' e tyre mbi atë; edhe *ay* i hipi.
- 8 Edhe shumë *veta* shtruanë rrobat' e tyre mb' udhët; edhe të-tjerë këputninë dega prej drurëve, e i shtroninë mb' udhët. Edhe ata që shkoninë përpara, *si* edhe ata që vininë prapa, bërtisninë, dyke thënë, Hosanna, i-bekuar' *është* ay që vjen mb' emërit të Zotit.
- 10 E-bekuarë *është* mbretëria (që vjen mb' emërit të Zotit,) e atit t' ënë Dhavidh; Hosanna
- 11 mbë të lartat. Edhe Jisuj hyri ndë Jerusalem, edhe ndë hieroret; edhe si vuri re përqark të-gjitha, me-qënë-që ishte tani vonë, doli ndë Vithani bashkë me të dy-mbë-dhjetëtë.
- 12 Edhe mbë të-nesërmet, si dualinë nga
- 13 Vithania, i erdhi uri. Edhe kur pa një dru fiku për-së-largu që kish fletë, erdhi, semos gjente gjë mb' atë; edhe si erdhi mb' atë, s' gjeti gjë, veç fletë; sepse s'ish kohë fiqsh.
- 14 Edhe (Jisuj) u-përgjeq e i tha *drurit të fikut*, Asndonjë mos hëngërtë më pemë prej teje për jetë. Edhe nxënësit' e ati e dëgjoninë.
- 15 Edhe vijnë ndë Jerusalem; edhe Jisuj, si hyri ndë hieroret, zuri të kërrenjë jashtë ata që shisninë e blininë ndë hieroret; edhe truvezat' e truvezarëve, edhe fronet' e atyreve
- 16 që shisninë pëllumbatë i përmbysi; Edhe nukë linte asndonjë të shkonjë enë ndëpër
- 17 hieroret. Edhe mësonte, dyke u then' atyre,

- Nuk' është shkruarë, „Se shtëpia ime dotë quhetë shtëpi lutjeje për gjithë kombetë?“ po
- 18 ju e bëtë „shpellë kursarësh.“—Edhe dëgjuanë shkronjësit' e kryepiftëritë, edhe kërkoninë qysh t'a prishnjënë; sëpsë kishinë frikë prej ati, se gjithë gjindja çuditej për mësimn' e ati.
- 19 Edhe kur ungrys, dilte jashtë qytetit.
- 20 Edhe ndë mëngjest dyke shkruarë, panë
- 21 dryrin' e fikut të-tharë që nga rrënja. Edhe Pjetri si ukujtua i tha ati, Ravvi, shih, drur'
- 22 i fikut, që mallëkove, utha. Edhe Jisuj upërgjeq, e u tha atyre, Kini besë mbë Perëndinë.
- 23 Sepse me të-vërtetë po u them juve, se kush t' i thotë këti mali, Ngreu, edhe hidhu ndë dett'; edhe të mos jetë me dy mëndje ndë zëmëret të ti, po të besonjë, se sa thotë bënë-
- 24 nenë, dot' i bënë' ati çdo që të thotë. Përandaj po u them juve, gjithë sa të lypni dyke falurë, besoni, se *dot'* i merrni, edhe dot' u
- 25 bënëne juve. Edhe kur të rriini të faleni, ndjeni, ndë paçi gjë kundër ndonjëj, që edhe Ati juaj që është ndë qiejt t' u ndjenjë juve fa-
- 26 jetë t' uaj. Po ndë mos *u'a* djefshi ju, as Ati juaj që është ndë qiejt nukë dotë ndjenjë fajetë t' uaj.
- 27 Edhe vijnë përsëri ndë Jerusalem; edhe ay tek ishte dyke ecurë ndë hieroret, vijnë tek ay kryepiftërit' edhe shkronjësit' edhe
- 28 pleqtë, E i thonë, Me ç' farë pushteti bënë

këto? edhe cili të ka dhënë këtë pushtet që
 29 të bëjsh këto? Edhe Jisuj upërgjiej, e u tha
 atyre, Edhe unë dot' u pyes juve një fjalë;
 edhe përgjiq-m'-uni, edhe *atëhere* dot' u them
 30 juve, me ç' farë pushteti bënj këto; Pagëzimi
 i Joanit prej qielli ishte, a po prej njerësve?
 31 përgjiq-m'-uni. Edhe *ata* mendoneshinë me
 vetëhen' e tyre, dyke thënë, Ndë thëncimë
 Prej qielli, dotë thotë, Përse pra s' i besuatë
 32 ati? Po ndë thëncimë, Prej njerësve, kishinë
 frikë nga llauzi; sepse të-gjith' e kishninë
 33 Joaninë, se ishte me të-vërtetë profit. Edhe
 ata upërgjiejnë e i thanë Jisujt, Nukë dimë.
 Edhe Jisuj upërgjiej e u tha atyre, As unë
 s' u them juve me ç' farë pushteti bënj këto.

Krye 12.

1 Pasandaj zuri t' u flasë atyre me paravolira. Një njeri beltoj një veshtë, edhe e thuri me garth, edhe rëmoj një tirë, edhe ndërtoj një pirk, edhe e pajtoj ndër bujqër, edhe iku
 2 ndë dhe të-huaj. Edhe ndë kohët të *pemëvet* dërgoj një shërbëtuar te bujqëritë, që të marrë
 3 rrë prej bujqërvet nga pem'e veshtit; Po ata e zun' edhe e rrahë, edhe e dërguanë
 4 pë sbrazëtë. Edhe përsëri dërgoj një tjetërë shërbëtuar tek ata; po edhe atë e rahnë me gurë, edhe i çanë kryetë, edhe e dërguanë
 5 prapë të-turpëruarë. Edhe përsëri dërgoj një tjetërë; po edhe atë e vranë; edhe shumë të-

tjerë dërgoj, po disa i rrahë, edhe disa i
 6 vranë. Dyke pasurë pra edhe një bir, të-dashurin' e ti, e dërgoj edhe atë tek ata mbë
 ndë lunt, dyke thënë, Se dotë kenë turp prej
 7 t' im biri. Po ata bujqëritë thanë njëri me tjetrinë, Se ky është trashëgimtati; ejani, let'a
 8 vrasimë, edhe trashëgimi dotë jetë yni. Edhe e muarnë, edhe e vranë, edhe e hojnë jashtë
 9 veshtit. Ç' dotë bënjë pra i zot' i veshtit? Dotë vinjë, e dotë prishnjë bujqëritë, edhe
 10 veshtinë dot' u'a apë të-tjerëve.—As këtë shkronjë s' e keni kënduarë, „gurinë që s' e pëlqyen' ata që ndërtonjënë, ky ubë krye çipi;
 11 prej Zotit ubë këjo, edhe është' e-çudiçime ndë syt t'anë.“
 12 Edhe *ata* kërkoninë t'a zënë; po patnë frikë nga gjindja; sepse e kupëtuanë, se për ata e tha paravolinë; edhe e lan' e iknë.
 13 Edhe dërgonjënë tek ay ca nga Farisenjtë edhe nga Irodhianëtë, që t'a zënë me fjalë;
 14 Edhe ata erthnë, e i thonë, E dimë se je i-vërtetë edhe se s' do të dish as prej njeriu; sepse nukë shikon mbë faqe njerësve, po mëson udhën' e Perëndisë me të-vërtetë; Esht' e udhësë t' i apëmë Qesarit pagesë, apo jo?
 15 të apëmë, a të mos apëmë? Edhe ay dyke njohurë ipokrisin' e atyre, u tha, Ç' më ngisni?
 16 bi-më-ni një dinar që t'a shoh. Edhe ata i prunë. Edhe ay u thot' atyre, E kujt është këjo fytyrë, edhe këjo përmbishkronjë? Edhe ata i

- 17 thanë, E Qesarit. Edhe Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Epni Qesarit ato që janë të Qesarit, edhe Perëndisë ato që janë të Perëndisë. Edhe *ata* uçuditnë për atë.
- 18 Pastaj vijnë tek ay Sadduqenj, të-cilëtë thonë, se s'ka të-ngjallurë; edhe e pyetnë,
- 19 dyke thënë, Mësonjës, Moisiu na ka shkruarë, se ndë i vdektë ndonjëj i vëllaj, edhe të lërë grua, edhe të mos lërë bij, i vëllaj të marrë gruan' e ati, edhe të ngjallnjë farë për
- 20 të vëllan' e ti. Ishinë pra shatë vëllezër; edhe i-pari mori një grua, edhe kur vdiq nukë la
- 21 farë; Edhe i-dyti e mori atë, edhe vdiq, po
- 22 as ky s'la farë; edhe i-treti gjithashtu. Edhe të shatë e muarnë atë, edhe nukë lanë farë;
- 23 më prapa nga gjithë vdiq edhe gruaja. Mbë të-ngjallurit pra, kur të ngjallenë, e cilit nga ata dotë jetë gruaja? sepse *që* të shtatë e patnë atë grua.
- 24 Po Jisuj upërgjeq, e u tha atyre, A nukë gënjeneni për këtë, sepse nukë dini shkronjatë, as fuqin' e Perëndisë? Sepse kur të ngjallenë prej së vdekurish, as martojnë, as martonjenë, po janë posi ëngjëjtë që janë
- 26 ndë qiejt. Edhe për të-vdekuritë se ngjallenë, nukë kini kënduarë ndë vivilët të Moisiut, si i tha ati Perëndia ndë ferrët, dyke thënë, „Unë jam Perëndia i Avraamit, edhe Perëndia i Isaakut, edhe Perëndia i Jakovit?“ Perëndia nuk është *Perëndi* i të-vdekurve, po i të-gjallëve; ju pra gënjeneni shumë.

- 28 Atëhere një nga shkronjësitë, që dëgjoj ata se po haheshinë me fjalë, dyke diturë, se mirë upërgjeq atyre, u afërua, edhe e pyeti,
- 29 Cila porosi është e-para e të-gjithave? Edhe Jisuj i upërgjeq, Se e-para e gjithë porosivet është, „Dëgjo, Israil, Zoti Perëndia ynë është
- 30 një Zot; Edhe të duash Zotinë Perëndinë t' ënt me gjithë zëmërenë t' ënde, edhe me gjithë shpirtinë t' ënt, edhe me gjithë mëndjenë t' ënde, edhe me gjithë fuqinë t' ënde.“
- 31 Këjo është e-para porosi. Edhe e-dyta që gjan me këtë është këjo, „Të duash të-afërminë t' ënt posi vetëhenë t' ënde.“ Tjatërë porosi
- 32 më të-madhe nga këto nukë ka. Edhe shkronjësi i tha, Mirë, Mësonjës, me të-vërtetë the, se një Perëndi ka, edhe s' ka tjetërë veç ati;
- 33 Edhe se t'a dojë njeriu atë me gjithë zëmërenë, edhe me gjithë nëndjenë, edhe me gjithë shpirtinë, edhe me gjithë fuqinë, edhe të dojë të-afërminë posi vetëhen' e ti, është më tepërë se gjithë të-gjithëdjeguratë edhe se
- 34 kurbanëtë. Edhe Jisuj kur pa atë, se upërgjeq me mënt, i tha, Nukë je lark nga mbretëria e Perëndisë. Edhe asndonjë më s' ku-xonte t'a pyesë.
- 35 Edhe Jisuj upërgjeq e tha, dyke mësuarë ndë hieroret, Qysh thonë shkronjësitë, se
- 36 Krishti është bir' i Dhavidhit? Sepse vetë Dhavidhi ka thënë me anë të Frymës' së-Shenjtuarë, „I tha Zoti Zotit t'im, Rri prej

se-djathtësë s' ime, gjersa të vë armiqt' e tu
 37 ndënkëmbje të këmbëveve të tua. " Vetë Dha-
 vithi pra i thotë Zot; edhe nga është bir i
 ati? Edhe gjithë gjindjesë i kishte ënda t'a
 38 dëgjonjë atë. Edhe u thoshte atyre ndë më-
 simt të ti, Ruhi nga shkronjësitë, të-cilëtë
 duanë të ecëjnë me stolira, edhe të-përshën-
 39 doshura ndëpër tregjet, Edhe frone të-parë
 ndëpër sinagogjit, edhe vënde të-parë ndëpër
 40 darkat; Të-cilëtë hanë shtëpit' e *gravet* të-va,
 edhe *këtë e bëjnë* dyke shtyrë shkak, se falenë
 shumë; këta dotë marrënë më tepërë mundim.
 41 Edhe Jisuj ndënji kundruell arkës' s' as-
 pravet, edhe vinte re qysh gjindja hithte të-
 holla ndë arkët të aspravet; edhe shumë të-
 42 pasurë hithninë shumë. Edhe erdhi një e-ve
 e-varfërë, edhe hodhi dy të-imëta, do-me-
 43 thënë një kodhrant. Edhe Jisuj thirri për anë
 nxënësit' e ti, e u tha atyre, Me të-vërtetë po
 u them juve, se kjo e-ve e-varfërë hodhi më
 tepërë se të-gjith' ata që hotnë ndë arkët t'
 44 aspravet. Sepse të-gjithë prej tepëricës' së
 tyre hotnë; po kjo prej skamjes, së saj hodhi
 gjithë sa kishte, gjithë gjën' e saj.

Krye 13.

1 Edhe tek po dilte nga hieroreja, i thotë
 një nga nxënësit' e ti, Mësonjës, shih ç'farë
 2 gurë e ç'farë ndërtesa! Edhe Jisuj upërgjeq,
 e i tha, Sheh këto ndërtesa të-mëdha? nukë

dotë mbesë gur mbi gur që të mos rrëzonetë.
 3 Edhe tek po rrinte ndë malt t' Ullinjët,
 kundruell hieroresë, e pyetninë atë veçanë
 Pietri edhe Jakovi edhe Joani edhe Andreu,
 4 Thuaj-na, kur dotë bënenë këto, edhe ç' shë-
 një *dotë jetë*, kur dotë mbaronenë këto të-
 5 gjitha? Edhe Jisuj, dyke përgjegjurë, zuri t'u
 thot' atyre, Vini re, se mos u gënjenjë ndonjë
 6 juve. Sepse shumë veta dotë vijnë mb' emë-
 rit t' im, dyke thënë, Se unë jam; edhe dotë
 7 gënjenjënë shumë *veta*. Edhe kur të dëgjoni
 luftëra, edhe zëra luftërash, mos ufrikësoni;
 sepse duhetë të bënenë *këto*, po edhe nuk'
 8 është fundi. Sepse dotë ngrihetë komp kundrë
 kombi, edhe mbretëri kundrë mbretërie;
 edhe dotë bënenë tërmete vënde mbë vën-
 de, edhe dotë bënenë zira e trazyra. Këto
 9 janë të-nisurat' e të-dhëmburavet. Po juve
 vështroni vetëhenë t' uaj, sepse dot' u apënë
 juve ndër duar ndëpër bashkëndënje, e ndë-
 përr sinagogjira dotë rriheni, edhe përpara qi-
 vernitarëve e mbretërve dotë rriini për punë
 10 t' ime, për dëshmim mb' ata. Edhe duhetë të
 lëçitetë Ungjilli më përpara ndëpër gjithë
 11 kombet. Edhe kur t'u shpienë që t' u apënë
 juve ndër duar, mos ukujdesni që më parë,
 se ç' dotë flisni, as mos umendonni; po ç' t' u
 epetë juve nd' atë orë, këtë flisni; sepse s'
 jini ju ata që flisni, po Frym' e-Shënjtëruarë.
 12 Edhe i vëllaj dotë apë ndër duar të vë-

- llanë për vdekje, edhe i ati të birrë; edhe djemtë dotë ngrënë krye kundrë përintvet,
- 13 edhe dot' i vrasënë. Edhe të-gjithë dot' u kenë mëri për emërinë t'im; po kush të duronjë gjer ndë funt, ky dotë shpëtonjë.
- 14 Edhe kur të shihni ndyrësin' e të shkretuarit, që është thënë nga profiti Dhaniil, ndënjurë tek nukë duhetë, (ay që këndon letë kupëtonjë), atëhere ata *që të jenë* ndë Judhet,
- 15 letë ikëjnë ndëpër malet; Edhe ay *që të jetë* mbi kulmt të shtëpisë, letë mos sbresë ndë shtëpit, as letë mos hynjë të marrë gjë nga
- 16 shtëpi' e ti; Edhe ay që të jetë nd' arët, letë mos kthenetë prapa që të marrë rrobën' e ti.
- 17 Po mjer' ato që janë me barrë, edhe ato që
- 18 kanë foshnjë ndë gji nd' ato dit. Edhe faluni që të mos bënetë të-ikuritë t'uaj ndë dimërë.
- 19 Sepse *nd' ato dit* dotë jetë i-këtitillë shtrëngim, që i-atillë nuk' është bërë që ndë kryet të kriesësë, që krioj Perëndia, e gjer tani, edhe
- 20 as është për të bërë. Edhe Zoti të mos i kishte shkurtuar' *ato dit*, s' kishte për të shpëtuarë asndonjë mish; po për të-sgjedhuritë që i ka. sgjedhurë shkurttoj dittë.
- 21 Edhe atëhere ndë u thëntë juve ndonjë, Na këtu është. Krishti, a, Na, atje mos besoni.
- 22 Sepse dotë ngrihenë krishtër të-rrem e profitër të-rrem, edhe dotë bëjnë shënja e çudira, që të gënjenjë, ndë mundetë, edhe të-sgjedhuritë. Po ju vini re; na tek u'a thashë juve të-gjitha që përpara.

- 24 Po nd' ato dit, pas ati shtrëngimi, djelli
- 25 dot' erretë, edhe hëna nukë dotë apë dritën'e saj, E yjt' e qiellit dotë bjenë, edhe fuqitë që
- 26 janë ndë qejt dotë tundenë. Edhe atëhere dotë shohënë të Birin' e njeriut dyke ardhurë
- 27 rë ndër re me fuqi shumë e me lavdi. Edhe atëhere. dotë dërgonjë ëngjëjt' e ti, edhe dotë mbledhë të-sgjedhurit' e ti nga të katrë erëratë, prej këndit të dheut e gjer mbë këntë të qiellit.
- 28 Edhe prej drurit të fikut mirrni vesh paravolinë; kur deg' e atij bënetë e butë, edhe
- 29 nxjer fletëtë, dimi, se vera është' afërë; Kështu edhe ju, kur të shihni këto se bënenë,
- 30 di-e-ni se është' afërë, ndë dyert. Me të-vërtetë po u them juve, se ky bres nukë dotë
- 31 shkonjë, gjersa të bënenë këto të-gjitha. Qielli edhe dheu dotë shkonjë; po fjalët e mija nukë dotë shkonjë.
- 32 Edhe për atë ditë a orë as ndonjë nukë di, as ëngjëjtë që janë ndë qiellit, as Biri, veç Ati.
- 33 Vini re, rrini sgjuarë edhe faluni, sepse
- 34 nuk' e dini kur është koha. *Sepse këjo dotë jetë* posi një njeri i ikurë, i-cili la shtëpin' e ti, edhe u' a dha pushtetnë shërbëtorëvet të ti, edhe si cilit punën' e ti, edhe portarin' e
- 35 porositi të rrijë sgjuarë. Rrini sgjuarë pra; (sepse s' dini kur vjen i zot' i shtëpisë, mbë të-ngrysurë, a ndë mest të natësë, a ndë

36 këndimt të kokoshit, a ndë mëngjest;) Se mos
vinjë papandehuraj e u gjenjë juve dyke
37 flejturë. Edhe ato që po u them juve, u' a
them të-gjithëve, Rrini sqjuarë.

Krye 14

- 1 Edhe pas dy ditsh ishte pashka edhe pa
brumjetë; edhe kryepiftërit' edhe shkronjë-
sitë kërkoninë, si t' a zënë me kobim, edhe
2 t' a vrasënë. Edhe thoshinë, Mos ndë të krem-
tet, se mos bënetë trazyrë nga llauzi.
- 3 Edhe tek ishte ay ndë Vithani, ndë shtë-
pit të Simonit të-krromosurë, dyke ndënjurë
ndë mësallet, erdhi një grua që kish një
allavastrë me vaj ere prej nardhe së-thjeshtë
e shumë së-shtrënjtë; edhe si e theu alla-
vastrënë, e derdhi vajnë përmbi kryet t' ati.
- 4 Edhe ishinë ca *veta* që zëmëroneshinë ndër
vetëhet të tyre, e thoshinë, Përse të humba-
së ky vaj ere? Sepse ky munt të shitej për-
mbi tre qint dinarë, edhe të epeshinë ndë-
për të-vobeqt; edhe zëmëroneshinë kundrë
asaj.
- 6 Po Jisuj tha, lër-e-ni; përse-i epni mun-
7 dime? punë të-mirë bën mbë mua. Sepse të-
vobeqtë i kini gjithënjë me vetëhenë t' uaj,
edhe kur të doni, n.untni t' u bëni mirë aty-
8 re; po mua nukë më kini gjithënjë. Atë që
mundi ajo, e bëri; i arriu që përpara të ly-

- enjë me vaj ere trupnë t' im për të-varrosu-
9 ritë t' im. Me të-vërtetë po u them juve, Kudo
të lëçitetë ky ungjill ndë gjithë botënë, edhe
puna që bëri kjo dotë flitetë për kujtim t' asaj.
- 10 Edhe *atëhere* Judhë Iskarioti, një nga të
dy-mbë-dhjetëtë, vate te kryepiftëritë që t' u' a
11 apë atë atyreve ndër duart. Edhe ata kur
dëgjuanë, ugëzuanë; edhe i u zotuanë t' i a-
pënë ergjende. Edhe ay kërkonte, si mbë kohë
të-pëlqyerë t' a trathëtonjë atë.
- 12 Edhe të-parënë ditë të *së-kremtes'* së pa
brumjever, kur bëninë kurban pashkënë, nxën-
nësit' e ati i thonë, Ku do të vemi e të bëj-
13 më gati që të hash pashkënë? Edhe ay dër-
gon dy nga nxënësit' e ti, edhe u thot' atyre,
Ecëni ndë qytet, edhe dot' u pjekë juve një
njeri dyke mbarturë një shtëmbë uje; ecëni
14 pas ati, Edhe ku të hynjë ay, tho-i-ni të zott
të shtëpisë, Se Mësonjësi thotë, Ku është
të-dënjuritë ku dotë ha pashkënë bashkë
15 me nxënësit' e mi? Edhe ay dot' u dëftenjë
juve mbë të-lartë një dhomë të-mathe të-
16 shtruarë gati; atje bëni gati për mua. Edhe
nxënësit' e ati duallë edhe erdhnë ndë qy-
tett, edhe gjetnë sikundrë u kishte thënë,
edhe bënë gati pashkënë.
- 17 Edhe kur ungrys, vjen me të-dymbë-dhje-
18 tëtë; edhe tek po rrininë ndë mësallet e po
haninë, Jisuj tha, Me të-vërtetë po u them
juve, Se një prej jush dotë më trathëtonjë,

- 19 ay që ha bashkë me mua. Edhe atyre zuri t' u vinjë keq, edhe t' i thonjë një nga një, Mos *jam* une? edhe t' jateri, Mos *jam* unë?
- 20 Edhe ay upërgjiej e u tha atyre, Një nga të dy-mbë-djetëtë, ay që ngiyen bashkë me
- 21 mua ndë kupët. I Bir' i njeriut vete, si kundrë është shkruarë për atë, po mjerë mb' a-të njeri, me anë të të-cilit trathëtonetë; mirë ishte për atë njeri të mos kishte lindurë.
- 22 Edhe tek po haninë, Jisuj mori bukë, edhe si bekoj, e theu, edhe u' a dha atyre-ve, edhe tha, Merrni, (hani); Ky është trupi
- 23 im. Edhe mori potirrë, edhe si ufal ndersë, u' a dha atyre, edhe pinë prej ati të-gjithë.
- 24 Edhe u tha atyre, Ky është gjaku im, ay i dhjatës' së-re, që derdhetë për shumë veta.
- 25 Me të-vërtetë po u them juve, Se nukë dotë pi më nga pem' e hardhisë gjer mb' atë ditë kur dot' a pi të-re ndë mbretërit të Perëndisë.
- 26 Edhe si psallnë, duallnë ndë malt t' Ulinjet.
- 27 Edhe Jisuj u thot' atyre, Se të-gjithë dotë skandaliseni mbë mua këtë natë; sepse është shkruarë, „Dot' i bje bariut, edhe dhënj-
- 28 të dotë përndahenë.“ Po passi të ngjallem,
- 29 dotë vete më përpara se ju ndë Galilet. Po Pjetri i tha, Edhe të-gjithë ndë uskandhali-
- 30 çinë, po unë jo. Edhe Jisuj u thot' atyre, Me të-vërtetë po të them, se sot këtë natë, para se të këndonjë këndesi dy herë, tri herë do-

- 31 të më mohojsh. Po ay edhe më tepërë thoshte, Se ndë udashtë të vdes unë bashkë me ty, nukë dotë të mohoj. Gjithashtu edhe të-gjithë të-tjerëtë thoshinë.
- 32 Pastaj vijnë ndë një vënt që thuhetë Gjethsimani; edhe u thotë nxënësve të ti, Rrini këtu gjërsa të falem.
- 33 Edhe merr me vetëhe Pjetrin' edhe Jakovin' edhe Joaninë, edhe zuri të frikësonet' e
- 34 t' i vinjë rëndë. Edhe u thot' atyre, Shpirti im është i-hidhëruarë gjer mbë vdekje; mbe-
- 35 tuni këtu, edhe rrini sguarë. Edhe ay si shkoj pak përpara, ra përdhe, edhe falej që, ndë qoftë se është e-mundurë, të shkonjë prej
- 36 atij *kjo* orë. Edhe thoshte, Avva, o Atë, të-gjitha janë të mundura tek ti; mërgo-e prej meje këtë potir; po letë bënetë jo ç' dua unë, po ç' do ti.
- 37 Edhe vjen, edhe gjen ata dyke fleturë; edhe i thotë Pjetrit, Simon, po fle? s' munde një orë të rrish sguarë? Rrini sguarë,
- 38 edhe faluni, që të mos hyni ndë ngasje; sepse shpirti është gati, po mishi është i-
- 39 bëtë. Edhe përsëri vate, e ufal dyke thënë po atë fjalë.
- 40 Edhe kur ukthye i gjet' ata përsëri dyke fleturë; sepse syt' e atyreve ishinë rënduarë, edhe nukë dininë ç' t' i përgjigjen' ati.
- 41 Pastaj vjen të-tretënë herë, e u thot' atyre, Flini pra, edhe prëhi; mjaft; erdhi ora;

na i Bir' i njeriut tek epetë ndër duart të
42 fajtorëve; sgjohi, letë vemi; na ay që më
trathëton tek uafërua.

43 Edhe për-një-here, tek ishte ay edhe dy-
ke folurë, vjen Judha, që ishte një nga të
dy-mbë-dhjetëtë, edhe bashkë me atë shumë
gjindje me thika e me dru, prej anës' së
kryepriftëret e të shkronjësve e të pleqet.

44 Edhe ay që e trathëton u kishte dhënë aty-
re shënjë, dyke thënë, se Atë që të puth,
ay është; zir-e-ni, edhe shpi-e-ni siguruar-
45 shim. Edhe kur erdhi, për-një-here uafërua
tek ay, e i thotë, Ravvi, Ravvi; edhe e pu-
46 thi. Edhe ata vunë duart' e tyre mbi atë,
edhe e zunë.

47 Edhe një nga ata që rrinin' atje hoqi thi-
kënë, e i ra shërbëtorit të kryepriftit, edhe i
preu veshnë.

48 Edhe Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Posi
mbë kursar kini dalë me thika e me dru të
49 më zini? Përdita kam qënë ndër ju ndër hie-
rorët dyke mësuarë, edhe nukë më zutë; po
këjo ubë që të mbushenë shkronjatë.

50 Edhe të-gjith' e lan' e iknë.

51 Edhe një farë djaloshi i vinte prapa dyke
qënë i-pshtjellë mbë lakuriq me një pelhu-
52 rë; edhe djaloshët' e zënë. Po ay e la pelhu-
rënë; edhe iku nga ata lakuriq.

53 Edhe prunë Jisunë te kryeprifti; edhe mbli-
dhenë tek ay gjithë kryepriftërit' e shkronjësitë.

54 Edhe Pjetri i vate pas prej se-largu gjer
brënda ndër hoborrt të kryepriftit; edhe ishte
dyke ndënjurë bashkë me shërbëtorëtë, edhe
po ngrohej ndër zjarrt.

55 Edhe kryepriftërit' edhe gjithë bashkë-ndë-
nja kërkoninë dëshmim kundrë Jisujt që t' a
56 vrasënë, po nukë gjeninë. Sepse shumë *veta*
dhanë dëshmim të-rrem kundrë ati; po dë-
57 shmimetë nuk' ishinë si-një-një. Edhe ca un-
gritnë e eppinë dëshmim të-rrem kundrë ati,
58 dyke thënë, Se neve e degjuam' atë të thotë,
Se unë dot' a prish këtë tempullë të-bërë
me dorë, edhe për tri dit dotë ndërtonj një
59 tjetërë të-pabërë me dorë. Po as kështu dë-
60 shmim' i atyre s' ishte si-një-një. Atëhere
kryeprifti ungrit ndër mest, e pyeti Jisunë,
dyke thënë, Nukë përgjigjesh asgjë? ç' dë-
61 shmim apënë këta kundrë teje? Po ay s' bën-
te zë, edhe nukë përgjigjej asgjë.

Përsëri kryeprifti e pyeti atë dyke thënë
62 ati, Ti je Krishti, i Bir' i të-Bekuarit? Edhe
Jisuj tha, Unë jam; edhe dotë shihni të Birr'e
njeriut dyke ndënjurë prej së-djathtës' së fu-
qisë, edhe dyke ardhurë bashkë me ret' e
63 qiellit. Atëhere kryeprifti çori rrobat' e tia,
e thotë, Ç' nevojë kemi më për dëshmimta-
64 rë? E degjuatë villasfiminë; ç' u duketë juve?
Edhe ata të-gjithë e gjykuanë, se është faj-
65 tuar për vdekje. Edhe ca zunë t' a pshtynjë-
në, edhe t' i mbulonjëne fytyrënë, edhe t' i

bjenë shuplaka, edhe t' i thonë, Profiteps. Edhe shërbëtorëtë i bininë me purteka.

- 66 Edhe Pjetri tek po ishte poshtë ndë hoborrt, vjen një nga shërbëtorët e kryepri-
67 Edhe kur e pa Pjetrinë dyke ngrohurë, shty-
ri sytë mb' atë, e tha, Edhe ti jeshe bash-
68 kë me Jisu Nazarinasinë. Po ay e mohoj,
dyke thënë, Nukë di, as nukë marr vesh,
Ç' thua ti. Edhe dolli jashtë udë vëntt për-
69 para hoborrit; edhe këndesi këndoj. Edhe
shërbëtoreja kur e pa atë përsëri, zuri t' u
thot' atyre që ishinë dyke ndënjur' atje, Se
70 ky është nga ata. Po ay përsëri e mohonte.
Edhe pas pak herë ata që ishinë dyke ndë-
njur' atje përsëri i thanë Pjetrit, Me të-vër-
tetë je nga ata; sepse je Galileas, edhe të-
71 foluritë t' ënt gjan. Po ay zuri të nemnjë
edhe të bënë be, Se nuk' e di këtë njeri që
72 thoni. Edhe këndesi këndoj për-së-dyti. Edhe
Pjetrit i ra ndër mëntt fjala që i pat thënë
Jisuj, Se para se të këndonjë këndesi dy he-
rë, dotë më mohojsh tri herë. Edhe zuri të
qanjë.

Krye 15

- 1 Edhe për-një-herë ndë mëngjest kryepri-
ftëritë bashkë me pleq' e me shkronjësitë,
edhe gjithë bashkë-ndënja mbajtnë këshillë,
edhe si e lithnë Jisunë, e prunë, edhe e dha-
në ndër duart të Pillatit.

- 2 Edhe Pillati e pyeti, Ti je mbreti i Judhe-
njvet? Edhe ay upërgjeq e i tha, Ti po thua.
3 Edhe kryeprihtëritë e përfllisninë shumë.
4 Edhe Pillati përsëri e pyeti, dyke thënë, Nukë
përgjigjesh asgjë? shiko sa dëshmonjënë kun-
5 drë teje. Po Jisuj më nuk' upergjeq asgjë,
kaqë sa Pillati çuditej.
6 Edhe për të-kremte u lëshonte atyre një
7 të-lidhurë, cilinë të lypnin' ata. Edhe një,
që thuhej Varavva, ish lidhurë bashkë me
shokët' e ti trazim-uxjerës të-cilëtë ndë tra-
8 zimt kishinë bërë vrasje. Edhe gindja bërtiti,
e zuri të lypënjë të bënë sikundrë përherë
9 bënte mb' ata. Edhe Pillati upërgjeq atyre,
dyke thënë, Doni t' u lëshonj juve mbretin' e
10 Judhenjvet? Sepse dinte se për cmir e kishinë
dhënë ndër duar kryeprihtëritë.
11 Po kryeprihtëritë shtynë gjindjenë të ly-
pëjnë më tepërë t' u lëshonjë atyre Varavvanë.
12 Edhe Pillati upërgjeq përsëri, e u tha atyre,
Ç' doni pra t' i bënë këti që i thoni mbret' i
13 Judhenjvet? Edhe ata përsëri bërtitnë, Kryqë-
14 zo-e. Edhe Pillati u thosh atyre, Përse, ç' të-
keqe ka bërë? Po ata më tepërë bërtitnë,
Kryqëzo-e.
15 Edhe Pillati, passi donte t' i bënte zëmë-
rënë gjindjesë, u lëshoj Varavvanë, edhe Ji-
sun' e dha ndër duar, passi e rahu me frush-
kullë, që të kryqëzonetë.
16 Atëhere ushtëtarëtë e prunë përbrënda ho-

- borrit, që është pretoreja(*), edhe mbledhënë
 17 gjithë tufën' e ushtëtarëvet. Edhe i veshnjënë
 një rrobë të-kuqe, edhe gërshetuanë një ku-
 18 rorë ferrash, e j'a vënë rreth kresë. Edhe zu-
 në t'a përshëndoshnjënë, *dyke thënë*, Gëzohu,
 19 o mbret' i Judhenjvet. Edhe i bininë kresë me
 kallam, edhe e pshyninë, edhe bininë mbë
 20 gjunj, e i faleshinë. Edhe si e përqeshnë, i
 sveshnë rrobën'e-kuqe, edhe i veshnë rrobat'
 e tia, edhe e shpunë jashtë, që t'a kryqë-
 zonjënë.
 21 Edhe zënë angari, për të ngriturë kryqin
 e ati, një farë Simon Qyrineas, t'an' e Alek-
 sandrit edhe të Ruffit, i-cili shkante *andej*,
 22 dyke ardhurë nga ara. Edhe e bjenë ndë vëntt
 Gollgotha, qe e-kthyerë do me thënë, Vend'
 23 i kresë. Edhe i epninë të pijë verë të-përzjerë
 me smirnë; po ay nuk' e mori.
 24 Edhe si e kryqëzuanë, ndanë rrobat'e ati
 dyke shtyrë shortë mbi ato, ç'të marrë sicili.
 25 Edhe ish ora tri, edhe e kryqëzuanë.
 26 Edhe përmbishkronja e fajit t'ati ish shkru-
 arë përsipër, **Mbreti i Judhenjvet**.
 27 Edhe bashke me atë kryqëzonjënë dy
 kursarë, një prej së-djathtësë, e një prej së-
 28 mëngjërës' s'ati. Edhe umbush shkronja që
 thotë, „Edhe me të-paudhëtë unumërua“.
 29 Edhe ata që shkoninë *andej* e shaninë,

*) Pretore ishte pallati a shtëpi e qevernitarit.

- dyke tundurë krerët' e tyre, e dyke thënë, Ua,
 ti që prish tempullinë, edhe për tri dit e ndër-
 30 ton, Shpëto vetëhenë t'ënde, edhe sbrit nga
 31 kryqi. Kështu edhe kryepriiftërit' e përqesh-
 ninë ndë mest të tyre bashkë me shkronjë-
 sitë, e thoshinë, Të-tjerë shpëtoj, vetëhen' e
 32 ti s'munt t'a shpëtonjë. Krishti mbreti i Isra-
 ilit letë sbresë tashi nga kryqi, që të shohëmë
 edhe të besojmë. Edhe ata që ishinë kryqë-
 zuarë bashkë me atë e shaninë.
 33 Edhe kur ubë ora gjashtë, ubë një errë-
 sirë mbë gjithë dhenë, gjer mbë të nëntën' orë.
 34 Edhe mbë të-nënttën' orë Jisuj bërtiti me
 zë të-math, dyke thënë, „Elloi, Elloi, llama
 Sabahthani?“ që e-kthyerë do me thënë,
 „Perëndia im, Perëndia im, përse hoqe dorë
 35 prej meje?“ Edhe disa nga ata që ishinë dyke
 ndënjurë atje, kur dëgjuanë, thoshninë, Na tek
 36 po thërret Ilinë. Edhe një usul, e mbushi një
 sfungar me uthullë, edhe e vuri mbi një ka-
 llam, e i tha të pijë, dyke thënë, Lini, letë
 shohëmë, ndë vjen Ilia t'a sbresë.
 37 Edhe Jisuj nxori një zë të-math, edhe dha
 shpirtinë.
 38 Edhe kurtina e tempullit uça mbë dy, prej
 së-larti gjer poshtë.
 39 Edhe urdhër-qindësi, që ish ndënjurë kun-
 druell, ati, kur pa, se dyke bërtiturë kështu dha
 shpirtinë, tha, Me të-vërtetë ky njeri paska
 qënë Bir Perëndie.

40 Ishinë edhe gra dyke vënë re prej së-lar-
gu; ndër ato ish edhe Maria Magdhalini, edhe
Maria e ëm' e Jakovit të-vogëlë edhe e Jo-
41 siut, edhe Salloma, Të-cilatë, edhe kur ish
ndë Galilet, i vininë pas, edhe i shërbeninë;
edhe shumë të-tjera që patnë hipurë bash-
kë me atë ndë Jerusalem.

42 Edhe tani si ungrys, (sepse ishte e-prëmte,
43 do-me-thënë *dita* para së-shëtunësë), Erdhi
Josifi që ishte nga Arimathea, *një* i-nderçim
këshillës, që edhe ay priste mbretërin' e Pe-
rëndisë; edhe kuxoj e hyri te Pillati, edhe
44 lypi trupin' e Jisujt. Edhe Pillati uçudit, ndë
qoftë se kishte vdekurë tani; edhe thërriti
përanë krye-qindësinë, edhe e pyeti, ndë ka
45 kohë që vdiq. Edhe si mori vesh prej krye-
46 qindësit, i fali trupinë Josifit. Edhe *ky* bleu
pëlhurë, edhe e sbriti, edhe e pshtolli me
pëlhurënë, edhe e vuri ndë *një* varr, që ishte
latuarë prej një shkëmbi; edhe rrukulisi një
gur ndë derët të varrit.

47 Edhe Maria Magdhalini edhe Maria e
ëm' e Josiut vininë re ku po vihëtë.

Krye 16.

- 1 Edhe si shkoj e-shëtuna, Maria Magdha-
lini, edhe Maria e *ëm'* e Jakovit, edhe Sallo-
ma, blenë erëra, që të vijin' e t'a lyenjëne.
- 2 Edhe shumë çpejt ndë mëngjest të-parënë

- ditë* të javësë vijnë ndë varrt, tek po linte
3 djelli. Edhe thoshninë ndë mest të tyre, Cili
dotë na rrukullisnjë gurinë prej derës' së va-
4 rrit? Edhe kur shtynë sytë, shohënë se guri
ish rrukullisurë; sepse ishte fort i-math.
- 5 Edhe si hynë ndë varrt, panë një djalosh
dyke ndënjurë mb' anë të-djathtë, të-veshurë
6 me rroba të-bardha; edhe utrëmpnë. Po ay
u thot' atyre, Mos utrëmpni; kërkon i Jisu Na-
zarinasinë, që ukryqëzua; ungjall, nuk' është
7 këtu; na vëndi ku e vunë. Po shkoni, e u thoni
nxënëset t' ati, edhe Pjetrit, se ay vete më
përpara se ju ndë Galilet; atje dot'a shihni,
8 sikundrë u tha juve. Edhe *ato* duallnë *çpejt*,
e iknë nga varri; sepse i kish *zënë* të-dri-
dhur' e të-habiturë; edhe asnjëri s' i thanë
gjë; sepse kishinë frikë.
- 9 Edhe si ungjall ndë mëngjest të-parënë
ditë të javësë, i uduk të-parënë herë Marisë
Magdhalini, prej së-cilësë kishte kërryerë
10 shtatë djaj. Ajo vate, e u dha zë atyreve që ki-
shinë qënë me atë, *atje* tek ishinë dyke bë-
11 rë vajë e dyke qarë. Edhe ata kur dëgjuanë,
se rron, edhe se upa nga ajo, nukë zunë besë.
- 12 Edhe pastaj udëftye mbë tjetërë formë
mbë dy *veta* nga ata, tek po ecninë dyke
13 vaturë nd' arë. Edhe ata vanë e u dhanë zë
të-tjerëvet; po as atyreve s' u zunë besë.
- 14 Pastaj udëftyc mbë të një-mbë-dhjetët, tek
ishinë dyke ndënjurë ndë mësallët, edhe i

shau për pabesërin' e atyre, edhe për zëmë-
rën' e-ashpërë, sepse nuk' u zunë besë aty-
reve, që e panë të-ngjallurë.

15 Edhe u tha atyre, Shkoni ndëpër gjithë
botënë, edhe lëçiti ungiilinë ndëpër gjithë

16 kriesënë. Kush të besonjë edhe të pagëzo-
netë; dotë shpëtonjë; po kush të mos beso-

17 një dotë dënonetë. Edhe shënja mb' ata që
dotë besonjë dotë jenë këto, Mb' emërit
t' im dotë kërrenjënjë djaj, gjuhëra të-ra dotë

18 flasënë; gjërpënj dotë zënë; Edhe ndë pifshi-
në ndonjë farë gjëje që sjell vdekje, nukë
dot' u bënë dëm atyreve; përmbi të-smurë
dy duar dotë vënë, edhe dotë shëronenë.

19 Zoti pra, passi u foli atyre, hipi ndë qiellit
edhe ndënji mbë anë të-djathë të Perëndisë.

20 Edhe ata duallë e lëçitnë kudo, edhe Zoti
ishte dyke punuarë bashkë me ata edhe dyke
vërtetuarë fjalënë me çuditë që e shoqëro-
ninë. Amin.